

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E hënë, 20 mars 2023

2 [Konferencë mbi ecurinë e çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 9.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

7 Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është

9 KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,
10 Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për

12 procesverbal, të katër të akuzuarit po na ndjekin me

13 videolidhje sot.

14 Sa i takon seancës së sotme, do të bëjmë një pushim rreth

15 orës 11. Do të mblidhemi në orën 11.30, do të vazhdojmë deri

16 në orën 13.00. Nëse është nevoja, do të bëjmë pushim dreke.

17 Dhe do kthehemi në orën 14.30 dhe do të vazhdojmë deri në

18 16.00, nëse është e nevojshme. Shpresojmë të mos jetë shumë e

19 nevojshme të kalojmë pas orës 13.00, prandaj ju lutem palëve,

20 pjesëmarrëse që të bëjnë parashtrime të shkurtra dhe koncize

21 në qoftë se është e mundur.

22 Sikurse e dini, më 15 shkurt të këtij viti, Trupi Gjykses

23 caktoi këtë konferencë për ecurinë e çështjes. Programi me

24 shkrim qarkulloi më 15 mars 2023. Sikurse u bë me dije në

25 rendin e ditës, Trupi Gjykses do t'i kërkojë informacion ZPS-

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 së edhe palëve sa i takon parashikimin përlllogaritjes kohore
2 për 12 dëshmitarët e parë edhe sa kohë i duhet mesatarisht
3 ZPS-së për të pyetur dëshmitarët dhe për këtë do të flas më në
4 hollësi tani.

5 Gjatë konferencës që patëm në dhjetor edhe konferencës
6 përgatitore për ZPS-në në shkurt, i kërkuam ZPS-së të shikonte
7 me imtësi përmasën e çështjes dhe Trupi Gjykses vë në dukje se
8 vërtetë ZPS-ja ka marrë disa hapë për ta shkurtuar ngarkesën
9 apo çështjen: konkretisht, kanë shkurtuar numrin e
10 dëshmitarëve dhe orëve që nevojiten për të pyetur ata. Akuzat
11 mbeten të njëjta.

12 Gjithashtu Trupi Gjykses e ka parasysh se përlllogaritja e
13 ZPS-së është një faktor që shërben në tërësi për këtë çështje.

14 Sidoqoftë, nëse nuk ka kundërshtime nga Trupi Gjykses,
15 është që evidencat e 12 dëshmitarëve të parë parashikohen të
16 zgjasin rreth 234 orë, që është më shumë se 35 [sipas
17 përkthimit] ditë në Gjykatë. Kjo do të thotë se prezantimi i
18 provave nga ZPS-ja mund të zgjasë më shumë seç ka parashikuar,
19 në fakt, ZPS-ja.

20 Nëse përdorim këtë përlllogaritje, atëherë dëshmitarët e
21 parë, 7 dëshmitarët e parë do të mbarojnë para pushimit të
22 Gjykatës. Pastaj do të vazhdonim me dëshmitarët e tjerë, por
23 ama nuk do të mbaronim dot para shtatorit apo tetorit 2023.
24 Nëse përdoren të njëjta vlerësime kohore për paketën tjetër të
25 12 dëshmitarëve, i bie që paketa e dytë të mbarojë rreth

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 janarit 2024. Edhe ngelen pastaj janari, shkurti dhe marsi për
2 të përfunduar vitin e parë.

3 Dhe Trupi Gjykses vlerëson se nëse janë më tolerantë në
4 qasjen e tyre do të dëgjonim rreth 46 dëshmitarë në vit me
5 këtë përllogaritje. Bazuar në informacionin që na është
6 paraqitur dhe faktin që kemi 312 dëshmitarë, që është numri i
7 fundit që na ka raportuar ZPS-ja, përfshirë dhe pyetjet nga
8 pala kundërshtare, i bie që duhen 6.5 vite për t'i përfunduar.

9 Trupi Gjykses mendon që 6.5 vite vetëm për provat e ZPS-
10 së është e tepërt. E kemi bërë të qartë qëndrimin tonë më
11 përpara dhe kemi thënë që ZPS-ja ta reduktojë përmasën e
12 provave të veta dhe Trupi Gjykses mendon që edhe Mbrojtja
13 duhet të reduktojë kohën që i nevojitet për të kundërpyetur
14 dëshmitarët.

15 Tani do t'u kërkoj parashtrime palëve edhe Mbrojtësit të
16 Viktimave i cili nuk ka qenë -- ka qenë shumë i
17 konsiderueshëm, e ka marrë shumë në konsideratë kohën dhe e
18 vlerësoj këtë, çfarë hapash mund të marrim ne për të reduktuar
19 kohën që nevojitet për 12 dëshmitarët e parë. Edhe vërtetë
20 pres këtu parashtrime konkrete. Mos më jepni përgjigje të
21 vagullta dhe mos ju shmangni. Sepse po i afrohem fillimit të
22 gjykimit.

23 Z. Prokuror, ju lutem fjala për ju.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Thjesht për procesverbal. Ne jemi
25 një ekip më i vogël sot sesa herët e tjera, është Ward

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 4

1 Ferdinandusse, Sebastian Van Hooydonk edhe unë, Matt Halling.

2 Unë do të flas për pikën e parë në rendin e ditës,
3 ndonëse, në fakt, ato që thatë ju i mbulojnë të dyja pikat e
4 para në rendin e ditës.

5 Për 12 dëshmitarët e parë, në fakt, synojmë t'i
6 rishikojmë përlllogaritjet kohore që kemi bërë. Do të
7 rishikojmë në raport me të gjithë informacionin që kemi marrë
8 dhe zhvillimeve gjatë gjykimit dhe këtu përfshihet edhe
9 orientimi që keni bërë ju për dëshmitarët dhe vendimin e
10 rregullës 154 të javës së kaluar; që është F01380.

11 Ne tani po përgatisim dëshmitarët, sigurisht, që do të
12 fokusohemi për të reduktuar sa më shumë kohën që na nevojitet
13 për ta. Gjithashtu, jemi shumë të interesuar që të jemi sa më
14 efikas dhe të jemi të shpejtë në procedurat tona. Askush nuk
15 do që gjyqi të vazhdojë me 6.5 vjet dhe ne e dimë se duhet të
16 jemi efikas edhe të shpejtë në mënyrë që të paraqesim provat
17 tona, jemi në dijeni për këtë.

18 Sa i takon masave dhe kjo është për pjesën e dytë në
19 rendin e ditës, po unë mund t'i trajtoj që tani në qoftë se
20 nuk e keni problem, i nderuar Gjykatës. Po.

21 Ka shumë masa që synon të marrë ZPS-ja për të reduktuar
22 kohën. Shumë janë diskutuar, shumë janë në rregullore. Vetë
23 rregulla 118(1), siç u përmend në konferencën përgatitore të
24 ZPS-së, nga ky Trup Gjykues.

25 Të gjitha alternativat ekzistojnë për ne edhe ato të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 5

1 rregullës 111 [sipas përkthimit], të heqim dëshmitarët
2 përsëritës, të reduktojmë vendndodhjet e krimeve, të përdorim
3 kampionime, të shkurtojmë kohëzgjatjen e pyetjeve të
4 drejtpërdrejta - të gjitha po i marrim parasysh. Sidoqoftë,
5 përshtatshmëria e këtyre masave varet nga faza në të cilën
6 ndodhet gjykimi, prandaj dhe po e vlerësojmë në mënyrë të
7 vazhdueshme.

8 Aktualisht ne po fokusohemi, sikurse dhe e keni parë të
9 nderuar Gjykatës, është të shkurtojmë sa më shumë pyetjet e
10 drejtpërdrejta edhe të shkurtojmë listën e dëshmitarëve të
11 drejtpërdrejtë apo *viva voce*. Ju besoj se e keni parë, që ne e
12 kemi reduktuar në 150 orë të pyetjeve të drejtpërdrejta dhe
13 kemi hequr 11 dëshmitarë nga lista jonë.

14 Një faktor tjetër që duam të theksojmë është se
15 dëshmitarët e parë do na japin informacion të rëndësishëm për
16 të parë pastaj nëse mund të paraqesim dëshmitarë të tjerë apo
17 mund t'i heqim tërësisht. Kemi prova të mëdha sa i takon
18 komunikatave të UÇK-së. Kemi vetë komunikatat. Kemi deklaratat
19 që janë bërë në shtyp. Kemi dokumente nga të akuzuarit. Kemi
20 deklaratat nga të akuzuarit. Kemi dëshmitarët brenda dhe jashtë
21 UÇK-së që flasin rreth këtyre.

22 Siç e kuptojmë ne, që në fakt dhe u habitëm,
23 autenticiteti i komunikatave të UÇK-së po kundërshtohet nga
24 Mbrojtja, prandaj ne na duhet ta vërtetojmë këtë. Po kjo nuk
25 do të thotë që domosdoshmërisht duhet të gjitha provat që kemi

1 për ta vërtetuar. Dhe kur të paraqesim provat e para me
2 dëshmitarët e parë, do të bëjmë edhe përshtatje sipas nevojave
3 në momentin që ne do të konsiderojmë që është vërtetuar ky
4 aspekt.

5 Duke pasur të gjitha këto parasysh, vlerësimi i plotë i
6 orëve që na duhen ne dhe që përmendni ju, i nderuar Gjykatës,
7 e kemi parashtruar këtë në dokumentin F1291 - dhe kjo është
8 për momentin koha më e përshtatshme që ne mund të paraqesim.
9 Megjithatë ne do të përpiqemi të shmangim dëshmitarët
10 publikues.

11 Ka dhe masa të tjera që mund të reduktojnë kohëzgjatjen e
12 gjykimit por që janë përtej kontrollit tonë, janë jashtë
13 kontrollit tonë. Pajtimet mes palëve të reduktojmë kuadrin e
14 pikave për pajtim faktik janë një nga shembujt më të mirë. Të
15 nderuar Gjykatës, ju përmendët edhe përlllogaritjen e
16 kundërpyetjeve nga ana e Mbrojtjes. Do vlerësonim edhe ne disa
17 sqarime nga ana e Mbrojtjes lidhur me përlllogaritjen që kanë
18 bërë ata për këtë pjesë.

19 Siç e mbani mend, secili nga ekipet e Mbrojtjes i
20 paraqiti në kohë të ndryshme përlllogaritjen e tyre kohore. Dhe
21 ne e masim në tërësi, në fakt, vihet në pikëpyetje nëse ekipet
22 e Mbrojtjes kishin koordinuar mes tyre kur paraqitën
23 përlllogaritjen kohore. Edhe nëse tolerojmë disa gjëra sepse
24 dëshmitarët e rregullës 154 do të zgjasin më shumë në
25 kundërpyetje sesa në pyetjet e drejtpërdrejta, ne mendojmë se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 është shumë e gjatë koha që kanë paraqitur ata dhe nuk
2 mendojmë se është e përligjur.

3 Duhet të jemi fleksibël dhe unë e kuptoj këtë, do të
4 flasim për këtë mbase më vonë gjatë ditës së sotme. Programi i
5 Gjykatës është i qartë, kalendari, do të jetë i përcaktuar kur
6 disa ditë do të kemi orë më të gjatë ose mbase ndonjëherë do
7 të përfshijmë ndonjë të premtë për ndonjë dëshmitar shtesë ose
8 jo. Megjithatë ne, nga jonë, do të jemi proaktivë, do të
9 evidentojmë të gjitha mundësitë për të njoftuar Trupi Gjykses
10 në mënyrë që të marrë vendimet e duhura sa i takon kalendarit.

11 Në seancën e fundit, të nderuar Gjykatës na dhatë një
12 datë që ta mbyllim paraqitjen e provave në prill 2025. Kjo
13 është e arsyeshme për ne edhe e mundshme, por kjo kërkon që të
14 gjitha palët, përfshirë këtu Mbrojtjen, të jenë të arsyeshëm
15 të jenë efikas në mënyrën sesi do të zhvillohet ky gjykim. Ne
16 nga ana jonë, do të jemi në mënyrë të vazhdueshme duke i
17 rishikuar provat tona. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e z.
19 Thaçi. Z. Kehoe, fjala është për ju.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëmëngjes.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
22 duhet të përgjysmoni përlllogaritjen tuaj.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Në fakt, nëse shikojmë Dëshmitarin
24 3, për të cilin ZPS-ja na ka dhënë me qindra, me qindra faqe
25 dhe kanë vendosur ta marrin në pyetje të drejtpërdrejta dhe ai

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 8

1 zgjatë dhjetë orë. Tani unë s'e di çfarë do të dalë e re në
2 këto dhjetë orë, por sigurisht që edhe kundërpyetjet do të
3 jenë të gjata se nuk e dimë çfarë do të bëjnë këta. Dhe kjo
4 vlen dhe për Dëshmitarin 7, kanë përcaktuar 12 orë për dëshmi
5 viva voce, jo sipas rregullës 154. Dhe kemi pastaj Dëshmitarin
6 10 për të cilin ka 9 orë.

7 Edhe për Dëshmitarin 7 dhe 10, janë me qindra dokumente.
8 Dhe kur shikoj dosjet me informacione është e vështirë. Ne s'e
9 dimë çka do thonë. A do thonë ndonjë gjë që s'ka lidhje me ato
10 që i kanë dhënë me shkrim ZPS-së? A do thonë diçka të re? A do
11 dalë ndonjë informacion i ri nga këta persona?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ua keni
13 drejtuar ju këtyre pyetjen?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Këtyre personave? Po përpiqem.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do ta
16 bëni tani pyetjen sepse shumë shpejt fillon gjykimi.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Sigurisht që ne po përpiqemi të
18 lexojmë 40.000 faqe me informacionin të paredaktuar. Do të
19 bëhem këngëtar në Las Vegas kaq shumë sa i përdor mikrofonat.

20 Pra, ne po përpiqemi të shohim informacionin.

21 Jemi konsultuar, i kemi konsultuar, kemi dëshmitarët e
22 parë, kemi folur me bashkëmbrojtësit për fushat kur nuk duam,
23 përpiqemi, të mos kemi përsëritje, kush do mbulojë cilën
24 pjesë. Kam folur me ekipin e z. Selimi për çështje që janë
25 vetëm në lidhje me z. Selimi dhe sigurisht për këtë ne nuk do

1 të kemi pyetje, e njëjta gjë, i njëjti konsultim është bërë me
2 z. Strong sa i takon z. Veseli.

3 Pra, ne kemi koordinuar. Megjithatë këta janë dëshmitarët
4 e tyre në tërësi. Dhe duhet thënë se edhe pse shohim
5 Dëshmitarin 6, për të cilin kanë vetëm 3.5 orë, për këtë
6 dëshmitar unë kam me qindra faqe provash materiale të cilat
7 duan t'i paraqesin përmes këtij dëshmitari edhe hamendësoj se
8 ata do të kenë shumë materiale, do të thonë, "A ke ndonjë
9 përfshirje në përgatitjen e këtij materiali?", do thonë "Po"
10 dhe duan t'i prezantojnë këto prova, dokumente të shumta, në
11 shumës. Pra, 3.5 orë vërtetë janë, po është informacion
12 shtrembërues duke e marrë parasysh tërësinë informacionit që
13 do të paraqesë dëshmitari.

14 Këta janë dëshmitarët e tyre. Ata po i sjellin këta
15 dëshmitarë. Ata po na thonë çfarë provash materiale duan të
16 paraqesin përmes tyre.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë ju pyeta,
18 ju a keni ndonjë ide konkrete si të shkurtoni paraqitjen tuaj
19 të provave. Jo të tyren.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, ajo që po përpiqem të them unë
21 është që ne flasim mes njeri-tjetrit si ekip i Mbrojtjes dhe
22 do të përpiqemi mos të kemi përsëritje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Po, për
24 shembull, për dëshmitarin e parë janë parashikuar 16, 18 orë
25 pyetjesh, 15 prej të cilave janë vetëm tuajat, pra, jo tuajat

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 10

1 po nga ana e Mbrojtjes.

2 A po na thoni ju që vlen ende sot kjo, qëndron ende apo
3 është kjo një përlllogaritje që e keni bërë me përfaqësi?

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Në fakt, është një numër me
5 përfaqësi. Nuk e kishim parë me kujdes.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, si e
7 kuptoj unë, ju po thoni që është dhënë maksimumi i kohës, jo
8 domosdoshmërisht që do të përdoret?

9 A mendoni ju se shtatë orë do të ishin më me vend në këtë
10 rast?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Më lejoni të konsultohem. Z. Misetic
12 është më i mençur se unë sepse ai do t'ia bëjë pyetjet këtij
13 dëshmitari.

14 Më lejoni të konsultohem, ju lutem.

15 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Z. Misetic këshillon që do të
17 përpiqemi sa më të kujdesshëm edhe do të përdorim një kohë sa
18 më të shkurtër kohore, por është një dëshmitar i rëndësishëm
19 edhe varet edhe nga përgjigjet e dëshmitarit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht.
21 Unë s'po ju detyroj të më jepni patjetër një numër fiks, po
22 është e rëndësishme të kuptojmë që kjo përlllogaritje, apo ky
23 vlerësim është dhënë para se të konsultohet apo se të ketë
24 konsultime mes ekipeve mbrojtëse.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, z. Gjykatës, por kemi pasur edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 11

1 mundësi të shikojmë ato mijëra faqe tani.

2 Dhe, ju e dini, i nderuar Gjykatës, i keni parë
3 dokumentet. Megjithatë nuk është gjithmonë rasti. Ne na duhet
4 kohë të shikojmë të gjithë informacionin që kemi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si mendoni ju
6 a është prilli datë e mundshme?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë mendoj të mbarojmë para prillit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po unë dua të
9 di a është e mundur?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, është e mundur, sepse sigurisht
11 nuk duam të marrim të gjitha informacionet, po nëse shohim
12 nocionet e provave jo gojore, kemi me mijëra faqe me
13 informacion që nuk thonë asgjë. Sepse ne jemi duke u përpjekur
14 të kuptojmë a është e nevojshme të shohim një për një këto
15 materiale? Sepse, në fakt, kjo kërkon dhe kohë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju keni qenë
17 prokuror më parë dhe ju e dini që Prokuroria duhet të ketë
18 mundësinë të vërtetojë çështjen e vetë. Prandaj është e
19 rëndësishme të fillojmë me supozimin që është e rëndësishme,
20 por mund të humbasim -- mund ta ndryshojmë me kalimin e kohës.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, si prokuror që
22 kam qenë unë në jetën time të mëparshme, mund t'ju them, që sa
23 më pak aq më mirë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe për
25 kundërpyetjet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 12

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Absolutisht, përsëritjet nuk i hyjnë
2 në punë askujt.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësoj.
4 Nuk dua ta zgjas më shumë seancën, po le të -- keni dhe një
5 gjë tjetër z. Kehoe.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa u takon provave të reja që
7 synojnë të paraqesin përmes këtyre personave që janë *viva voce*
8 dhe jo sipas rregullës 154, ne kundërshtojmë çdo provë të re
9 që paraqitet në këtë formë që nuk na është paraqitur
10 paraprakisht ne. Dhe unë uroj në mirëkuptimin tuaj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

12 Z. Veseli. Ju keni qenë pak më të arsyeshëm në
13 përllogaritjen tuaj kohore. Dhe jo vetëm "të arsyeshëm", po më
14 të shkurtuara.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] E vlerësoj. Ne kemi gati gjysëm
16 për gjysëm krahasuar, domethënë, e kemi përgjysmuar krahasuar
17 me përllogaritjen e parë.

18 Koha totale e parashikuar për 12 dëshmitarët e parë është
19 aktualisht 25.5, 25 orë e gjysëm. Ju duhet të kuptoni që kur
20 kemi dhënë këtë llogaritje, ne jemi fokusuar të shikojmë sesa
21 mund të jetë limiti, maksimumi dhe jo një përllogaritje reale
22 kjo.

23 Sigurisht jemi përpjekur të jemi sa më real, sigurisht,
24 ne mund të shtojmë edhe pesë orë e gjysëm.

25 Për shembull, për Dëshmitarin 2, mund t'i shkurtojmë dy

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 13

1 orë ose një. Për Dëshmitarin 3, mund ta reduktojmë nga pesë
2 orë në 3 orë. Për Dëshmitarin 4, nga dy orë në një orë. Por ju
3 lutem kini parasysh kjo është një përllogaritje, Dëshmitarët
4 5, 9 dhe 11, mund ta ulim apo ta reduktojmë me gjysmë ore dhe
5 për Dëshmitarin 12 me një orë e gjysëm kundrapyetjet. Këto i
6 thashë për të qenë në procesverbal.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Z. Roberts.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë mbështes ato që
10 tha z. Kehoe sa i takon përllogaritjeve që kemi dhënë. Ne kemi
11 dhënë pesë përllogaritje. Jemi duke punuar që të japim dhe
12 përllogaritjen për dëshmitarët e tjerë. Do ta bëjmë në kohën e
13 duhur dhe sa më shpejt që të jetë e mundur dhe do të përpiqemi
14 të jemi sa më të arsyeshëm kuptohet.

15 Sa u takon sugjerimeve për ta racionalizuar çështjen,
16 thjeshtuar çështjen, provat, do ta bëjmë dhe ne, megjithatë
17 kjo varet edhe nga Trupi Gjykses, kërkon dhe bashkëpunim nga
18 Prokuroria në mënyrë që të fokusohemi vërtetë në thelb të
19 aktakuzës.

20 Dhe meraku im është se përmbledhja e dëshmitarëve që po
21 paraqet Prokuroria lidhen dhe përfshijnë shumë aspekte që
22 sipas nesh janë jashtë kuadrit të aktakuzës. Dhe vetëm një
23 shembull do ju jap.

24 Dëshmitari i dytë synon, të paktën sipas Prokurorisë,
25 përmbledhjes që na dha Prokuroria, është paragrafi i fundit,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 14

1 rregulla 95(4), duan të japin prova për incidentet që kanë
2 ndodhur goxha kohë pas periudhës së aktakuzës. Ne mendojmë se
3 këto nuk janë prova që kanë lidhje me këtë çështje gjyqësore.

4 Dhe për t'ju treguar si ndikon kjo në kundrapyetjet tona,
5 aktualisht kemi përlllogaritur katër orë kundrapyetje për këtë
6 dëshmitar. Unë sugjeroj që nëse Prokuroria nuk do të lejohet
7 që t'i paraqesë provat si prova kryesore për këtë dëshmitar,
8 atëherë do ta përgjysmojmë edhe ne kohën tonë. Prandaj po them
9 që shkon përtej kuadrit të aktakuzës. Prandaj po them që kemi
10 përmbledhje të ndryshme, dëshmitarë të ndryshëm në grupin e
11 300 e ca dëshmitarëve që kemi.

12 Pra, varet nga Prokuroria nëse do t'i përdorin si prova
13 kryesore në këtë çështje dhe jemi në një situatë që po
14 përgatitemi dhe duhet të jemi të gatshëm ta kundrapyesim për
15 këtë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni pyetur
17 Prokurorinë?

18 Po, në qoftë se kjo është me rëndësi për ju diskutohen me
19 Prokurorinë.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, e kuptoj. Mbase Prokuroria
21 mund të na e konfirmojë. Tek përmbledhja e dëshmitarëve, me sa
22 kuptuam ne, ata synojnë t'i përdorin si prova kryesore. Do e
23 vlerësoja konfirmimin nga Prokuroria nëse vërtetë është
24 kështu, por unë kështu e kam kuptuar dhe me sa kuptoj unë nuk
25 shoh që të kenë plan ta ndryshojnë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prandaj po
2 them diskutojeni.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po. Në qoftë se është ky rasti,
4 flas për paragrafin 118 për Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit
5 ose Shtojca mbi Zhvillimin e Gjykimit, ku ne kundërshtojmë, në
6 fakt, këtë pjesë të dëshmisë së dëshmitarëve dhe aty thuhet se
7 duhet ta bëjmë të paktën një ditë paraprakisht.

8 Sigurisht, duhet ta bëjmë më përpara këtë gjë në kohë të
9 mjaftueshme paraprakisht, po në qoftë se nuk do të gjejmë
10 prova për këtë dëshmitar, ne nuk do të kemi fare kundërpjetje
11 dhe do të përditësojmë përlllogaritjen tonë dhe kështu do t'i
12 japim mundësinë Prokurorisë që të planifikojë dëshmitarin e
13 radhës. Prandaj, më mirë është për procesin gjyqësor në
14 përgjithësi që të rishikojë mënyrën sesi do të pyesim nga
15 dëshmitarë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që dhe
17 me një telefonatë mund t'i zgjidhni këto.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Përlllogaritja kohore që
21 kemi dhënë ne apo vlerësimi kohor që kemi dhënë ne është ajo
22 që kemi përlllogaritur, duke pasur parasysh vëllimin e
23 materialeve që kemi pasur asokohe.

24 Dhe që nga seanca e fundit që patëm ne me ju, i nderuar
25 Gjykatës, na u nxorën dhe 38 paketa të tjera materialesh. Që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 16

1 do të thotë po na vijnë materiale të tjera dhe jemi ende duke
2 punuar. Përllogaritja që kemi dhënë ne ka qenë përllogaritja
3 më e mirë që mund të bënim aso kohe. Nëse mund ta reduktojmë
4 do bëjmë të pamundurën, por në ato momente vetëm atë
5 përllogaritje mund të jepnim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë ide
7 konkrete sesi mund ta shkurtoni kohën?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Po. Prokuroria mund të thërrasë më
9 pak dëshmitarë dhe kështu e shkurtojmë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 Z. Laws, a doni të shtoni ndonjë gjë?

12 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Ne kemi kërkuar dy orë e
13 pesë minuta.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
15 përgjysmoni?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk besoj që mund ta reduktojmë më
17 shumë se aq, i nderuar Gjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 z. Laws.

20 Z. Veseli, ta ndërpreva një çik fjalën. Unë i pyeta të
21 gjithë nëse mund të kishin ndonjë ide sesi mund të na
22 shërbenin për të vendosur si ta reduktojmë kohën dhe nëse nuk
23 keni asgjë për të parashtruar shumë mirë.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Realisht, ne kemi dy vjet që i
25 biem daulleve për këtë, sa i takon provave të Prokurorisë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 17

1 Kemi arritur në një pikë edhe Trupi Gjykses është i mendimit
2 që Prokurorisë i është dhënë tashmë kuadri të paraqesë provat
3 e veta në rendin sesi dëshiron t'i paraqesë, kështu që nuk
4 mendojmë se do të bënte ndonjë ndryshim të madh.

5 Sigurisht, ne do të përpiqemi ta reduktojmë sa më shumë
6 kohën që të përpiqemi që të mos e zvarrisim shumë këtë gjykim.
7 Por, në momentin që do e fillojmë këtë rrugëtim të gjatë me
8 Prokurorinë në këtë gjykim dhe pavarësisht të dhënave që na ka
9 dhënë Prokuroria dhe këto janë në procesverbal, kushedi sa
10 herë Prokuroria ka dhënë premtime që s'i ka mbajtur, në
11 momentin që do e nisim këtë rrugëtim, unë besoj se vërtetë do
12 vijë një kohë ku Trupi Gjykses do thotë që po e teprojmë
13 shumë. Por unë kam kohë që e kam paralajmëruar këtë situatë
14 dhe zvarritjet që do të kemi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga ne nuk
16 dëgjuat ankesa për kohën që kishit përllëgaritur ju, kështu që
17 unë e vlerësoj këtë.

18 Do t'i marrim parasysh sugjerimet tuaja edhe arsyetimin
19 tuaj. Dhe nëse mendojmë që po japim materiale të tepruara apo
20 ka pyetje të tepërta nga të dyja palët, ne do të ndërmarrim
21 masat që gjykojmë ne se janë të nevojshme për ta përfunduar
22 këtë pjesë dhe sigurisht ne duhet të kemi parasysh një kohë të
23 arsyeshme.

24 Ju besoj se i njihni metodat që ka Trupi Gjykses,
25 rregulloren. Thamë që do ta fillojmë çështjen, do të shohim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 18

1 çfarë metodash ekzistojnë, do t'ju ndjekim kur të bëni pyetjet
2 por nuk do të hezitojmë të kufizojmë si Mbrojtjen, si ZPS-në,
3 sa i takon kohës që i është alokuar të dyja palëve. Ju lutem,
4 këtë kiheni parasysh. E kemi bërë më herët dhe do ta bëjmë
5 sërish nëse lind nevoja.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të ngre diçka, ju lutem?

7 Sigurisht që ne do të përpigemi ta reduktojmë sa më shumë
8 që të jetë e mundur. Kemi bërë një përkushtim, e kemi premtuar
9 këtë, por ama në qoftë se ndodh diçka gjatë pyetjeve është
10 mirë që të kemi pak liri veprimi sa i takon përdorimit të
11 kohës, pra, të përdorim më shumë kohë, nuk po them kohë të
12 jashtëzakonshme. Ju e dini, i nderuar Gjykatës, që shpesh
13 ndodhin gjëra në sallën e gjyqit që janë përtej kontrollit
14 tonë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë
16 hamendësoj dhe besoj se dhe ju e keni bërë se shumica prej
17 jush e keni bërë një përllogaritje në interesin tuaj dhe të
18 klientëve tuaj. Ne e dimë këtë. Dhe ne duhet të ndërmarim të
19 gjitha masat që gjykojmë se janë të nevojshme në momentin e
20 duhur dhe ne do ta bëjmë këtë. Faleminderit. Faleminderit për
21 parashtrimin tuaj.

22 Tani besoj që Gjykatësi Gaynor ka disa pyetje të
23 mëtejshme lidhur me të njëjtën çështje.

24 Keni fjalën.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Kam një pyetje

1 për ZPS-në pas parashtrimeve tuaja.

2 E kemi marrë parasysh atë që thatë që të gjitha opsionet
3 janë të mundshme dhe se ka shumë masa që mund të marrë ZPS-ja
4 ta zvogëlojë çështjen e saj. Ne e pranojmë qëndrimin tuaj.
5 Por, siç thatë dhe vetë, Trupi Gjykses ka të drejtën e vet për
6 të ndërhyrë dhe për ta ulur, për t'i ulur provat që do të
7 paraqesë ZPS-ja dhe e kam fjalën, për shembull, materialet e
8 rregullit 118(1).

9 Pasi dëgjova përgjigjet e Mbrojtjes sot, po ju pyes: Keni
10 ndonjë parapëlqim lidhur me hapat që mendoni që duhet të marrë
11 Trupi Gjykses kur të vijmë te momenti që ne mund të mos jemi
12 të kënaqur me hapat që do të merrni ju, pra, çfarë hapash
13 mendoni se do të ishin të përshtatshme për ta ulur, për ta
14 pakësuar kohëzgjatjen e çështjes së paraqitur prej Mbrojtjes?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Siç mund ta
16 imagjinoni, preferenca jonë do të ishte që të mos ishte e
17 nevojshme një gjë e tillë. Por duke menduar se ju do të
18 ndërmerrenit veprimet tuaja, cilat do të ishin ato, mendoj që
19 ne do të parapëlqenim që me ecurinë e çështjes, nëse Trupi
20 Gjykses me njohuritë që ka në atë moment për çështjen, do të
21 jetë në gjendje të identifikojë në mënyrë pohuese dëshmitarë
22 që nuk kanë nevojë që t'i dëgjojë, kjo do të ishte një masë që
23 për ne do të ishte informacion kuptimplotë për të bërë
24 përshtatjet tona. Pra, nëse ju do të jepni udhëzime që të mos
25 i marrim ata dëshmitarë duke ditur në atë kohë që do ishte një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 20

1 gjë e përsëritur dhe ne do të merrnim masat përkatëse.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
4 Mettraux, gjithashtu ka disa pyetje.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Edhe pyetjet
6 e mia janë për ju, z. Halling.

7 Kam një farë simpatie, do të thosha, për parashtrimet e
8 Mbrojtjes së z. Selimi lidhur me përmbledhjet e dëshmitarëve
9 tuaj. Dhe po e përmbledh këtë shqetësim.

10 Kemi marrë tre përmbledhje të provave të propozuara të
11 dëshmitarëve tuaj: Në kohën e dosjes paraprake bashkë me
12 listën e 12 dëshmitarëve, bashkë me kërkesën në bazë të
13 rregullës 154. Siç tha z. Roberts, ju keni ngritur një numër
14 çështjesh në këto përmbledhje. Dhe ajo që nuk është e qartë,
15 për mua të paktën, është nëse e para janë prova tek të cilat
16 do të mbështeteni apo që do të nxirrni nga dëshmitarët e
17 drejtpërdrejtë.

18 Edhe një shqetësim tjetër që ka dalë nga parashtrimet e
19 Mbrojtjes. Fakti që disa prej këtyre dëshmitarëve në
20 deklaratat e tyre ofrojnë dëshmi që lidhen me veprime dhe
21 sjelljen e një apo më shumë të akuzuarve, gjë që nuk është e
22 paraqitur në përmbledhjet tuaja.

23 Me sa kuptoj unë lidhur me qëllimin e përmbledhjeve është
24 që si Trupi Gjykes të dijë se çfarë, ku do mbështeteni ju
25 lidhur me çdo dëshmitar dhe, siç tha z. Roberts, ka rëndësi që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 21

1 edhe Mbrojtja ta dijë se çfarë ju keni ndërmend të përdorni,
2 ku do të mbështeteni, për të bërë përgatitjet e tyre.

3 Kur kemi një përmbledhje, për shembull, e cila nuk
4 pasqyron prova lidhur me veprimet dhe sjelljet e një të
5 akuzuari, në këtë rast, do të mendojmë që ju nuk do të
6 mbështeteni në këtë lloj dëshmie, apo që përmbledhjet tuaja
7 ashtu siç janë, janë të paplota, në qoftë se mund ta them
8 kështu?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Në vend që ta quaj "të paplotë"
10 mbase është më mirë të themi që për nga natyra e vetë
11 përmbledhja, përgjithëson një deklaratë të gjatë në një pjesë
12 të shkurtër.

13 Simpatia juaj, siç e thatë, duket edhe nga vendimi juaj i
14 marrë të premtën. Dhe aty ka udhëzime të qarta pikërisht për
15 këto çështje dhe ky udhëzim apo urdhër e kuptojmë që ka
16 përdorim të përgjithshëm, pra, kur kemi të bëjmë me dëshmi që
17 lidhen me veprime dhe sjelljen e të akuzuarve do të procedojmë
18 në mënyrën që duhet.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. E kuptoj
20 përmbledhja është përmbledhje. Por ajo që ka rëndësi si për ne
21 dhe për Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave duhet të kuptojmë
22 se në ç'pjesë të dëshmisë do të mbështeteni. Por ju më
23 siguroat me fjalët që thatë.

24 Pyetja e dytë ka të bëjë po me të njëjtën çështje. Ne
25 kemi marrë indikacione nga ju, në parashtrimin e 1 shkurtit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 22

1 2023, F02143, që është lista e 12 dëshmitarëve. Ju e dini, ju
2 keni listuar aty një numër provash materiale të cilat lidhen
3 me secilin prej këtyre dëshmitarëve. Disa janë ofruar dhe tani
4 janë pranuar nën 154. Tani duam të dimë se ç'keni ndërmend të
5 bëni me të tjerat. Me të njëjtin qëllim në mendje për të
6 kuptuar se çfarë duhet të presim për secilin dëshmitar dhe për
7 t'i mundësuar Mbrojtjes të dinë se çfarë dëshmisë do të
8 përdorni lidhur me çdo dëshmitar.

9 Pra, po provat materiale jo të lidhura me këto do t'i
10 përdorni për secilin dëshmitar?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Jo. Kjo lidhet me atë që thashë më
12 herët, është një temë të cilën do ta rishikojmë, do të bëjmë
13 rivlerësime me ecurinë e çështjes. Mund të ketë raste kur
14 prova të pranuar duhet t'i tregohen dëshmitarit për t'i futur
15 në një kontekst apo për të nxjerrë informacione të mëtejshme.
16 Por, do të ketë edhe prova të tjera që mund të mos jenë të
17 nevojshme në fushëveprimin e përgjithshëm të procesit.

18 Jo gjithçka, pra, do të paraqitet në bazë të F01243. Por
19 deklaratat se -- që përmbajnë deklaratat të mëparshme të
20 dëshmitarëve të cilat nuk do t'i paraqesim si prova. Por kur
21 të bëjmë këto përshtatje, pastaj do të kemi listën e
22 përgjithshme të cilën do ta paraqesim. Në qoftë se ka ndonjë
23 pyetje lidhur me një dokument konkret, jemi gati t'i
24 përgjigjemi.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të them sesa më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 23

1 shpejt që ta bëni, të paktën për ta informuar Mbrojtjen, aq më
2 mirë është me qëllim që ta ndihmoni të përshpejtojë
3 përgatitjet e veta.

4 Pyetja e tretë që kam përpara sesa t'i kthehem Mbrojtjes,
5 është lidhur me një dokument konkret që ju e ofroni në kuadër
6 të kërkesës tuaj jo gojore; është parashtrimi 01268. Dokumenti
7 ka numrin ERN SPOE00232092 deri në 094, në shtojcën 2.

8 Duam të sigurojmë që ta kuptojmë atë që ofroni, arsyen
9 pse e ofroni, sepse versionin në anglisht, kështu siç e kemi
10 ne, ka vetëm një fjali, në fakt, është një fjali e paplotë.
11 Dhe thotë:

12 "Kanë kaluar më shumë se dy muaj nga luftimet në zonën
13 operative..."

14 Kemi dhe versionin në shqip që e përmban atë fjali po
15 është më i gjatë, shumë më i gjatë. Në shpjegimin që jepni për
16 këtë dokument, në shtojcën që përmendet, duket se po
17 mbështeteni vetëm tek ajo fjali që sapo e lexova.

18 Pra, mos jeni duke -- do të ofroni të gjithë dokumentin
19 si në versionin shqip? Apo në versionin në anglisht me një
20 fjali të paplotë? Në qoftë se do të jetë kjo e fundit, na
21 shpjegoni cila është rëndësia, vlera provuese? Thjesht është
22 diçka që provon diçka apo është diçka thelbësore materiale?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt, e gjithë përmbajtja e
24 dokumentit do të paraqitet. Po, për t'ju përgjigjur pyetjes
25 duhet të kthehem pak pas që të shpjegoj kontekstin.

1 Dy faqet e fundit të cilat keni identifikuar në dokumente
2 gjenden në versione të shumta në shtëpinë e z. Jakup Krasniqi
3 nga ku janë marrë këto materiale. Faqet në parashtrimin e
4 identifikuar nga ju, janë versione të qarta digjitale. I
5 njëjti version i këtij dokumenti është gjetur në shtëpinë e
6 tij dhe aty ka ndryshime të shkruara me dorë dhe është ERN
7 SPOE00225101, 00225103. Pra, është edhe përkthimi në anglisht
8 në atë dokument, me ET.

9 Siç përmendët ju, faqja e parë, është vetëm një rresht,
10 por është fillimi i një drafti që bëhet pastaj Komunikata e
11 UÇK-së 53. Dhe, për ne, kur e gjetëm në shtëpinë e tij,
12 mbështetë më tej autorësinë e kësaj komunikate nga z.
13 Krasniqi.

14 Siç mund ta shikoni nga parashtrimi ynë jo gojor, jemi
15 përpjekur që të bashkojmë të gjitha komunikatat në atë
16 parashtrim, që do të thotë se faqja e parë ka rëndësi të
17 veçantë me atë parashtrim. Ndërsa dy faqet e tjera, ato janë
18 për një mocion të ardhshëm jo gojor. Dhe atëherë do t'i
19 paraqesim bashkë me përkthimin në anglisht.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani jam i qartë.
21 Faleminderit.

22 Mbrojtësi i z. Thaçi, ndonjë gjë për tre nga çështjet që
23 ngrita?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Lidhur me Komunikatën 54 dhe për ne
25 ishte mister duke pasur parasysh se nuk lidhej me asgjë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 25

1 tjetër, pra, nuk ishim të qartë lidhur me rëndësinë e këtij
2 dokumenti. Kemi një farë, jemi paksa më të qartë tani bazuar
3 nga dokumenti tjetër, por më duhet t'i kthehem dhe një herë
4 kësaj çështjeje.

5 Por, instinkti që pata ishte kështu si ju, pra, cili
6 është qëllimi, rëndësia e këtij dokumenti. Nuk dua të flas në
7 këtë moment sepse do të më duhet t'i kthehem dokumenteve të
8 tjera përpara se të flas.

9 Por, nëse më lejoni t'i kthehem çështjes së parë të
10 ngritur për disa pika të caktuara, disa dokumente të caktuara,
11 jemi ende të paqartë se çfarë pret Prokuroria nga materiali i
12 rregullës 54 ku mbështeten, ç'presin nga ne. Kjo thekson
13 vështirësinë që kemi ne për të gjetur rrugën tonë në morinë e
14 këtij informacioni, pra, janë jo vetëm deklaratat e
15 dëshmitarëve por gjithë këto materiale të tjera.

16 Ju mund ta trajtoni një deklaratë me 50 faqe apo kështu,
17 por bëhet fjalë për deklarata të shumta, qindra e qindra
18 faqesh. Nuk synoj që të ul entuziazmin tuaj, sepse ka disa
19 dëshmitarë që do të vijnë që mund të bëhet fjalë për një mijë
20 faqe informacion të rregullës 154. Pa pasur udhëzime nga juve
21 në bazë të material -- siç parashikohet nga rregulla 154 dhe
22 92 ter, lidhur me ato që ka thënë ky person, neve na duhet të
23 endemi përmes qindra faqeve të transkriptit që gjejmë vetë atë
24 që na duket me rëndësi kur ndoshta Prokuroria mund të mos ta
25 përdori atë material.

1 E kemi ngritur këtë shqetësim më përpara, por vazhdon të
2 ekzistojë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbrojtja e z. Veseli.

4 Z. Roberts.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thjesht po përpiqemi të vendosim
6 midis nesh kush do flasë i pari.

7 I vetmi parashtrim që kam ka të bëjë me përmbledhjen dhe
8 kjo lidhet me atë që thashë më parë mbasi i bëtë ju pyetjen
9 Prokurorisë. Ne jemi të shqetësuar nëse Prokuroria do të
10 paraqesë ndonjë dëshmi tjetër përtej këtyre deklaratave,
11 përmbledhjeve. Në qoftë se këto janë jashtë përmbledhjeve, do
12 ta kundërshtojmë.

13 Unë ndërkohë i kam çuar email Prokurorisë për ta pyetur
14 nëse do të paraqesë materiale që lidhen me dëshmitarin e dytë.
15 Siç e dimë nga procedurat në TPNJ dhe në gjykata të tjera,
16 gjithmonë zhvillohen diskutime të gjera lidhur me ato prova që
17 të paraqiten nëse përmbledhen apo jo në përmbledhje. Prandaj
18 Prokuroria duhet të jetë shumë e kujdesshme. Në qoftë se diçka
19 del jashtë këtij fushëveprimi, duhet ta njoftojnë Mbrojtjen
20 dhe Trupin Gjykses shumë paraprakisht dhe duhet, sugjeroj, të
21 kërkojnë leje, sepse kjo është detyra e Prokurorisë.

22 Në qoftë se kanë, pra, materiale të tjera, prova të
23 tjera, që të citojnë gjëra tjera të cilat nuk janë përfshirë
24 në këto përmbledhje, mendoj, që duhet të kërkojë autorizim,
25 pra, lejen e Trupit Gjykses.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 27

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Roberts.

2 Nuk them asgjë për të treguar nëse pajtohem ose jo me këto që
3 thoni, por e kemi marrë parasysh parashtimin tuaj edhe
4 shpresoj që keni marrë hapa që pas vendimit të javës së shkuar
5 lidhur me faktin që duhet të njoftoheni me provat që do të
6 paraqesë Prokuroria.

7 Z. Ellis.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Lidhur me përmbledhjet, kemi të
9 njëjtin perceptim se ka një problem lidhur me mënyrën sesi
10 janë përgatitur këto përmbledhje. Sa për t'u dhënë një
11 shembull dhe është fjala për Dëshmitarin 4147. Përmbledhja e
12 përgatitur nga Prokuroria nuk e përmend fare klientin tim, por
13 në deklaratën e atij dëshmitari - tek deklarata e kam fjalën
14 jo tek transkripti - klienti im duket se del 11 herë. Dhe ky e
15 tejkalon procesin e thjeshtë të përmbledhjes. Prandaj do të
16 mbështesim qëndrimin e z. Roberts.

17 Nëse më lejoni, mund të them që ky qëndrim është edhe më
18 i qartë lidhur me dëshmitarët e rregullës 154. Sipas urdhrin
19 tuaj të tretë në seancën e dhjetorit, Prokuroria duhej të
20 identifikonte çështjet, faktet, rrethanat në të cilat do të
21 merren në pyetje dëshmitarët.

22 Prokuroria e trajtoi këtë në parashtimin e vet 1262.

23 Përmbledhjet e disa dëshmitarëve në atë parashtim ishin shumë
24 më të shkurtra se ato të dhëna më parë dhe, mesa kuptojmë ne,
25 në hartimin e përmbledhjes, në përgjigje të urdhrin tuaj

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 28

1 konkret, Prokuroria ka përcaktuar çështjet, pyetjet, çështjet
2 për të cilat do të bëjë pyetje. Kurse çdo gjë jashtë këtyre,
3 ne do të paraqesim kundërshtim.

4 Shumë shkurt për sa i takon çështjes së dokumentit
5 SPOE232092. Përgjigja jonë për mocionin jo gojor do të vijë
6 nesër. Ne do të trajtojmë atë dokument dhe të tjera
7 plotësisht. Por paraqitja e një rreshti të vetëm nuk provon
8 asgjë. As autorësinë dhe as përfshirjen në hartimin e një
9 dokumenti të tillë pa e ditur se kur është prodhuar, kur është
10 përgatitur ky dokument.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.
12 Z. Laws.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë nuk kemi.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Misetiç.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Shumë shkurt, dua të më dëgjoni
16 lidhur me pyetjen e Gjykatësit Gaynor.

17 Dhe në përgjigje të ZPS-së apo propozimin e ZPS-së,
18 propozimi i ZPS-së do të ishte problematik, për mendimin tonë,
19 është Trupi Gjykses që duhet t'i thotë Prokurorisë se çfarë
20 dëshmitarësh nuk do të dëgjohen, kjo do të kërkonte disa
21 diskutime lidhur me gjërat që janë provuar përtej dyshimit të
22 arsyeshëm apo fakte që janë provuar për të cilat nuk keni
23 nevojë t'i dëgjoni më dëshmitarët dhe kjo do të ishte një
24 rrugë problematike për arsye që ju i keni të qarta.

25 Nga ana tjetër, në qoftë se ata u referohen gjërave që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 29

1 nuk diskutohen më, kjo është diçka që duhet zgjidhur *inter*
2 *partes* pa dëgjuar dëshmitarët. Por ne rezervojmë qëndrimin
3 tonë pasi ju të angazhoheni në këto lloj diskutimesh.
4 Faleminderit.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
7 Gaynor ka një pyetje.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Po kam një
9 pyetje për Mbrojtësin e Viktimave lidhur me parashtrimin 0285,
10 që është njoftimi i mëtejshëm i Mbrojtësit të Viktimave lidhur
11 me dëshirën e tyre për të bërë pyetje dëshmitarëve, dorëzuar
12 në shkurt 2023. Ju keni vënë në dukje disa çështje për të
13 cilat doni t'i bëni pyetje një dëshmitari me lejen e Trupit
14 Gjykues. Ju thoni që ka interes legjitim për viktimat që
15 marrin pjesë në proces dhe që kërkojnë të vërtetën.

16 Ju thoni që:

17 "Këto çështje do të trajtohen në qoftë se nuk janë
18 mbuluar plotësisht në pyetjet e Prokurorisë që do t'i bëjë
19 atij dëshmitari".

20 Pyetja që kam është: Së pari, e keni diskutuar me ZPS-në
21 nëse ZPS-ja do ta marrë në pyetje dëshmitarin për çështje që
22 ju keni identifikuar? Dhe, së dyti, nëse synoni të lidheni, të
23 bashkëpunoni me ZPS-në për situata të ngjashme në të
24 ardhshmen?

25 Z. LAWS: [Përkthim] Po, jemi lidhur me Prokurorinë; dhe

1 po, kemi arritur marrëveshje lidhur me qasjen që do të ndjekim
2 të dy palët. Ne do të sigurojmë që të mos ketë përsëritje
3 lidhur me pyetjet për këto tema.

4 Për sa i takon pyetjeve shtesë, po, synimi ynë do të jetë
5 që të lidhemi me ZPS-në kur çështje të tilla të dalin në të
6 ardhshmen.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Doni që Trupi Gjykses të
8 nxjerrë një vendim për kërkesën tuaj që këto pyetje t'ia bëni
9 dëshmitarit në përfundim të pyetjeve të drejtpërdrejta të
10 Prokurorisë?

11 Z. LAWS: [Përkthim] Po. Kjo do të na duhej, mënyra për të
12 marrë një vendim përfundimtar se vetëm në atë fazë do të jemi
13 plotësisht të qartë që ato që ne për të cilat duam të bëjmë
14 pyetje i ka bërë pyetje Prokuroria, i ka ezauruar. Sepse
15 Prokuroria ka shumë çështje të tjera për të trajtuar me këtë
16 dëshmitar krahasuar me ne.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Ne e pranojmë
18 propozimin tuaj dhe ju inkurajojmë që të ndiqni të njëjtën
19 qasje. Dhe përpara ndonjë njoftimi të ardhshëm lidhur me
20 pyetjet që doni t'ia bëni dëshmitarëve të cilat mund të
21 mbivendosen me pyetjet që do të bëjë Prokuroria gjatë pyetjeve
22 të drejtpërdrejta, ju lutemi lidhuni me ZPS-në paraprakisht
23 për t'u siguruar që ZPS-ja do t'ia bëjë pyetje dëshmitarit për
24 të njëjtat çështje.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Ashtu do të bëjmë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 31

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

2 Gjykatës Smith.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

4 Mettraux ka një pyetje apo disa pyetje për Mbrojtjen.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

6 Mbase është për të gjitha ekipet e Mbrojtjes. Dua të
7 sigurohem që i kuptojmë çështjet që do të paraqisni ju lidhur
8 me një çështje kritike që e keni paraqitur, po e përmbledh
9 mbas pak, po lidhur me rolin, funksionet, të drejtat e Shtabit
10 të Përgjithshëm të UÇK-së.

11 Ne e kuptojmë që shkurtimisht që provat që do të
12 paraqiten nga Prokuroria janë se klientët tuaj kanë qenë
13 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm që ka pasur kompetenca,
14 përgjegjësi të rëndësishme për shumë çështje - disiplinën,
15 emërimet e kështu me radhë.

16 Fokusi i pyetjes time ka të bëjë si ta kuptojmë ne
17 çështjen e Mbrojtjes lidhur me këto aspekte. Duke parë nga
18 dosjet paraprake dhe nuk dua të fut fjalët e mia në gojën
19 tuaj, po duket se ka një fije që i përshkon të katër dosjet
20 paraprake, një fije të përbashkët të themi dhe ky është një
21 rast që ju mund të shprehni mendimin tuaj.

22 Me sa kuptoj nga dosjet tuaja Shtabi i Përgjithshëm nuk
23 kishte fare ose kishte shumë pak kontroll për atë që ndodhte
24 në terren, se nuk kishte të drejta të pakufizuara
25 operacionale, se nuk kishte apo kishte shumë pak funksione

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 32

1 komanduese në zonat operative dhe se rregulloret dhe
2 komunikatat që lëshonte apo që na thoni se lëshoheshin ish-in
3 kryesisht të karakterit aspirues.

4 Pra, gjithsesi, ne e kuptojmë që vendimet operationale
5 komanduese që kanë të bëjnë me këtë çështjen janë marrë ose në
6 nivel lokal apo në nivelin e zonave operative dhe jo në
7 nivelin e Shtabit të Përgjithshëm. Kështu kjo është mënyra
8 sesi duhet ta kuptojmë ne çështjen apo provat që do të
9 paraqisni ju, apo është kjo përmbledhja që bëra një
10 përmbledhje e drejtë?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Ajo është shumë e drejtë. Ajo
12 pasqyron ato provat që ne do të paraqesim, gjatë procesit ju
13 do të dëgjoni nga dëshmitarët zinxhirin e komandës në UÇK,
14 gjatë 1998-1999 që ka qenë kaotike, e ndarë në brigada që kanë
15 qenë më vete si të thuash. Po këto janë disa nga dëshmitë që
16 do të paraqesin. Pasqyrohen jo vetëm nga pjesëtarët e UÇK-së
17 që ZPS-ja do të marrë në pyetje, po dhe nga dëshmitarë të
18 tjerë të cilët do të flasin që, në shkurt të 1999, autoriteti
19 i pavarur rajonal ka ekzistuar. Dhe, në mars të 1999, i njëjti
20 dëshmitar i ZPS-së ka thënë që "përpyekjet për të - është
21 fjala për marsin e 1999 - për t'i futur komandantët e zonave
22 në Shtabin e Përgjithshëm kanë qenë pjesërisht të suksesshme
23 sepse komandantët e zonës kishin pavarësi operationale".

24 Dhe jam i sigurt që ju e keni parë një gjë të tillë dhe
25 është një letër e Departamentit të Shtetit drejtuar Komitetit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 33

1 të Punëve të Jashtme në maj të 1999, ku z. Larkin, Asistent
2 Sekretar i Punëve Legjislative thotë që:

3 "Nuk ka një strukturë politike apo komandë, kontroll
4 efikas të UÇK-së".

5 Përveç plotësimit të analizës të përmbledhur, koncize, që
6 ju paraqitet, që është dhe qëndrimi ynë, kjo pasqyrohet dhe në
7 provat që do të avancojnë vetë dëshmitarët e ZPS-së.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Emerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju do të
11 shikoni rolin e Shtabit të Përgjithshëm në çështjen Veseli, e
12 përcaktuar qartë në paragrafin 7 dhe 21 të dosjes paraprake të
13 Veselit. Dhe më lejoni të theksoj një pjesë ku, në paragrafin
14 8 dhe 9, ne vëmë në dukje se në përpjekje për të kryer barrën
15 e provës, ZPS-ja e ka keqkuptuar apo e ka keqparaqitur rolin e
16 Shtabit të Përgjithshëm në UÇK-në që po krijohet, duke e
17 përshkruar gabimisht UÇK-në si një organizatë nga lart-poshtë
18 që kontrollohet nga ana operationale nga Shtabi i Përgjithshëm
19 në kohën përkatëse. Dhe këtë e gjeni në pjesët përkatëse të
20 dosjes paraprake të ZPS-së.

21 Ne vazhdojmë dhe themi, nuk shtrohet vetëm se çka themi ne
22 si Mbrojtje po ne themi një gjë. Dy trupa gjykues të TPNJ-së
23 janë mbështetur pak a shumë në të njëjtat prova që i
24 ashtuquajturit Shtabi i Përgjithshëm përbëhet nga një grup i
25 shpërndarë individësh që nuk kishin ndonjë shtab të përcaktuar

1 që madje as që nuk e njihnin njeri-tjetrin dhe jo
2 domosdoshmërisht e dinin se cilët ishin anëtarët e tjerë të
3 Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë, që nuk komuniknin me
4 njëri-tjetrin për të njëjtat arsye gjatë gjithë kohës, që ata
5 takoheshin rrallë apo nëse takoheshin ndonjëherë dhe që nuk
6 ishin gjithnjë të pranishëm në Kosovë.

7 Shkurtimisht, ne vëmë në dukje, konstatimet e TPNJ-së në
8 çështjen Haradinaj dhe Limaj, që ishin se ky organ, ashtu siç
9 ishte, nuk operonte si një Shtab i Përgjithshëm në kuptimin
10 konvencional të këtij të këtij termi. Dhe në aktgjykimin e
11 Limajt shikoni dhe arsyet për këtë vendim. Dhe kjo ka rëndësi
12 për ju kur të filloni të dëgjoni dëshmi. Paragrafi 132 i
13 aktgjykimit të Limajt gjykata thotë:

14 "Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm nuk takoheshin
15 rregullisht për shkak të situatës së sigurisë dhe
16 identifikoheshin jo me emra po me numra për të njëjtat arsye.
17 Në këto rrethana nuk është e habitshme që struktura
18 organizative dhe hierarkia e UÇK-së ishin të paqarta, apo nuk
19 njiheshin, për të jashtëm, për vëzhguesit e jashtëm dhe për
20 disa sugjerohet, ishte një paqartësi e vërtetë".

21 Në aktgjykimin e Haradinajt për të njëjtën çështje në
22 paragrafët 20 dhe 21, gjykata dhe është gjyqi i dytë i
23 Haradinajt, thotë që:

24 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kosovë nuk kishte një
25 vendndodhje ku qëndronte në 1998; anëtarët e tij lëviznin për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 35

1 arsye sigurie dhe pavarësisht zakonisht nga njëri-tjetri”.

2 Dhe aktgjykimi i referohet dëshmisë së Crosland që ishte
3 atasheu britanik i mbrojtjes në Republikën e Jugosllavisë në
4 Beograd. Dhe vazhdon në paragrafin 21:

5 “Trupi Gjykues dëgjoi nga koloneli Crosland se, ndërsa
6 UÇK-ja ishte organizuar, ta quash organin në krye të saj
7 “Shtab të Përgjithshëm” ishte jo i saktë. Ai mendonte se UÇK-
8 ja [sipas përkthimit] nuk kishte kontroll efikas ndaj UÇK-së.
9 Ai përfundon se nuk kishte shumë koordinim midis zonave dhe
10 Shtabit të Përgjithshëm.

11 “Shtabi i Përgjithshëm nxirrte deklarata politike,
12 komunikata dhe bënte intervista” për median ndërkombëtare “që
13 përcaktonin strategji dhe opinione politike të UÇK-së dhe jep
14 një ide të përgjithshme të luftimeve... që po
15 zhvilloheshin...”

16 Por siç bëhet qartë nga gjykata ajo nuk kishte kontroll
17 efikas në terren.

18 E vetmja gjë që përcaktohet në përmbledhje dhe unë nuk
19 është se nuk pajtohem fare me të po pajtohem pra, duhet të
20 shikoj nuanca në pjesën e fundit të tij. Sepse ju keni nxjerrë
21 konkluzionin tuaj që operacione të tilla strategjike që mund
22 të jenë zhvilluar në terren duhet të ketë qenë autorizuar në
23 nivel lokal apo në nivelin e zonave.

24 Siç do ta shohim, këto zona nuk ekzistonin deri në mesin
25 e verës së 1998, një apo dy dhe me kalimin e kohës pastaj

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 36

1 filluan. Komandantët e zonës nuk përgjigjeshin para Shtabit të
2 Përgjithshëm. Kjo është absolutisht e qartë dhe ju do ta
3 shikoni nga të gjitha dëshmitë që do të dëgjoni. Nuk
4 ekzistonte linja e komanduese në kuptimin konvencional.

5 Ta quash veten Shtab i Përgjithshëm është pak a shumë si
6 ai zotëria që është caktuar në zonën e Dukagjinit apo siç
7 quhet shefi i brigadës anti-tank që thonë. Nuk ekzistonte
8 brigada e anti-tankeve. Apo sektori i biologjik apo kimik. Për
9 të krijuar idenë që ishte një organizatë ashtu siç nuk ishte.

10 Pra, çdo supozim që ju në mënyrë të natyrshme do të
11 nxirrni lidhur me disa, ato që do të thonë personat që e
12 quanin veten anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm që përbëhej,
13 në fakt, nga fermerë, nga punëtorë, këto supozime nuk do të
14 kenë ndonjë peshë aty, në qoftë se kanë, do të ekspozohen si
15 të rreme gjatë provave që ne do të paraqesim. Këtë mund ta
16 themi me siguri të plotë sepse trupat gjykues që e kanë parë
17 këtë çështje me kujdes për vite me radhë të gjithë kanë
18 nxjerrë po të njëjtin konkluzion.

19 Pra, përmbledhja është e saktë. Por nuk është vetëm
20 përmbledhja e çështjes së Mbrojtjes. Por është përmbledhje e
21 asaj që ka ndodhur. Pra, ZPS-ja duhet të provojë që këto
22 konstatime, njoftime gjyqësore janë të gabuara. Sepse gjykatat
23 që ata mund të citojnë nuk kanë dëgjuar disa prova të cilat
24 Prokuroria do t'jua paraqesë. Po të jemi të qartë, në qoftë se
25 ka prova të tilla që Prokuroria synon t'i paraqesë, nuk i kanë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 37

1 identifikuar në dosjet e tyre paraprake apo në ndonjë nga
2 materialet që kanë paraqitur deri tani, prandaj do të
3 habiteshim po t'i paraqiste në këtë fazë.

4 Nuanca e fundit që mbetet është, a del që të gjitha
5 krimet në aktakuzë janë autorizuar në nivel zone? Jo, sepse
6 disa kanë qenë krime spontane të kryera nga persona në terren.
7 Disa kanë qenë larje hesapesh nga të ashtuquajtur anëtarë të
8 UÇK-së. Sa për të qenë të qartë se ç'kemi parasysh me fjalën
9 "anëtarë të UÇK-së", shqiptarët e Kosovës që kanë ndjekur një
10 grup në një moment, në një grup tjetër në një moment tjetër.
11 Një fermer gjatë ditës, luftëtar gjatë natës. Siç është thënë
12 nga një nga komandat e zonës "Isha komandant i atyre që
13 vendosnin një ditë të caktuar të vinin në ushtri". Nuk bëhet
14 fjalë për një ushtri. Është një organizim spontan që është
15 formuar nga njësitë e mbrojtjes në Kosovë të asaj që ata e
16 quanin me të drejtë një plan gjenocidi, fushatë spastrimi e
17 organizuar, krime kundër njerëzimit për t'i përzënë ata nga
18 vendi.

19 Prandaj thashë që nuk duam të futemi nga ana e gjërave --
20 nuk duam t'i shikojmë gjërat nga pikëpamja e serbëve.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Ishit shumë
22 i dobishëm në këtë koment. Z. Emmerson, faleminderit.

23 Z. Roberts.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Thjesht thënë, po, përmbledhja e
25 shkurtër që keni bërë juve është dhe konkluzioni ynë. Sipas

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 38

1 paragrafit 89 deri 95 të dosjes paraprake. Siç e kanë thënë
2 edhe kolegët e mi, është diçka për të cilën ne dakortësohemi
3 të gjithë. Nuk kam për të shtuar ndonjë gjë në këtë fazë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa më pak aq më mirë, z.
5 Roberts.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, ashtu është.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe unë do të ndjek këtë udhëzim.
9 Nuk kam gjë për të shtuar.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

11 Nuk po i kërkoj Prokurorisë që t'ju tregojë juve si të
12 ndërtoni argumentet tuaja, por në qoftë se keni ndonjë gjë për
13 të treguar tani ju e keni fjalën, z. Halling.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Nga marsi i 1998 deri në shtator
15 të 1999, UÇK-ja nuk ishte organizuar asnjëherë si një nga
16 forcat ushtarake të vendeve perëndimore, si për shembull,
17 Shtetet e Bashkuara. Ata janë organizuar me kalimin e kohës.
18 Dhe asnjëherë nuk kanë qenë të organizuar në mënyrë të
19 shkëlqyer, në mënyrën që secili çdo urdhër të jetë apo
20 procedurë të jetë ndjekur në të njëjtën mënyrë gjatë gjithë
21 kohës. Megjithatë provat tregojnë, përfshirë edhe materialet
22 të cilat janë konfiskuar dhe të cilat nuk janë paraqitur TPNJ-
23 së, ato tregojnë se ka pasur një konsolidim dhe funksionim të
24 hierarkisë së saj.

25 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka pasur kontroll mbi

1 njësitet e UÇK-së, por mënyra sesi e ka ushtruar këtë kontroll
2 ka ndryshuar me kalimin e kohës. Hashim Thaçi, Kadri Veseli,
3 Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi që të gjithë ishin anëtarë të
4 Shtabit të Përgjithshëm gjatë kohës së aktakuzës, ata e kanë
5 ushtruar rolin e autoriteteve, strategjitë dhe direktivat e të
6 cilave janë zbatuar, përfshirë edhe për sa i përket synimit të
7 përbashkët kriminal.

8 Të nderuar Gjykatës, përmbledhjet tona lidhur me Shtabin
9 e Përgjithshëm e kanë bërë të qartë këtë si në aktakuzë dhe në
10 dosjen paraprake dhe ne do ta zhvillojmë këtë më tutje.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pa shpenzuar kohë të mëtejshme,
13 do të them që z. Veseli mendon që paraqitja e tij në kuadrin e
14 Shtabit të Përgjithshëm është gjatë periudhës së aktakuzës, në
15 fakt, është krejtësisht e keqinterpretuar pasi nuk ka qenë
16 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm deri në pranverën 1999.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
19 kalojmë në çështjen e vetëmbrojtjes si taktikë që ka ngritur
20 Mbrojtja e Thaçit. Po ju them që më datën 20 shkurt, Mbrojtja
21 e Hashim Thaçit dorëzoi një njoftim të Mbrojtjes në emër të të
22 akuzuarit dhe pastaj e paraqiti synimin për të paraqitur
23 vetëmbrojtjen si taktikë.

24 Unë nuk dua që të kemi një -- e di që doni ta paraqisni
25 një PowerPoint. Një prezantim me PowerPoint. Ne nuk jemi

1 kundërshtues megjithatë nuk menduam që do të ishte e
2 përshtatshme për konferencën mbi ecurinë e çështjes penale që
3 po mbajmë sot. Por në qoftë se doni ta bëni këtë gjatë
4 periudhës së hapjes së argumenteve tuaja, dakord, na njoftoni
5 paraprakisht me shkrim.

6 Po i kthehem tani pyetjes së parë, që e kam për Mbrojtjen
7 e z. Thaçi. Besoj, z. Misetic, se ju do të përgjigjeni.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere,
10 Trupi Gjykses vëren se klienti juaj është ngarkuar me gjashtë
11 pika të krimeve kundër njerëzimit dhe katër për krime të
12 luftës. Dhe unë dua ta kem të qartë, nëse këtë argumentim të
13 vetëmbrojtjes, do ta shfrytëzoni gjatë gjithë kësaj kohe?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, për sa i
15 përket ndërmarrjes kriminale të përbashkët dhe faktit të
16 krimeve të paraqitura në aktakuzë, sipas ndërmarrjes kriminale
17 të përbashkët përgjigja është po. Po të ishte thjesht për
18 ndërmarrjen e përbashkët kriminale I, atëherë do të ishte kjo
19 një çështje të cilën do ta paraqisnim sipas aktakuzës. Dhe
20 prandaj, të gjitha këto të ndërlidhura.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
22 ndjesë.

23 Por nga kjo rrjedh që vetëmbrojtja përjashton
24 përgjegjësinë penale për sa i përket krimit të ndalimit
25 arbitrar, ndalimit, çështjeve të akteve çnjerëzore, trajtimit

1 mizor, torturës, që të gjitha këto vrasje me paramendim që të
2 gjitha këto janë të justifikuara në bazë të vetëm të
3 argumenteve të vetëmbrojtjes.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, në të njëjtën mënyrë siç i
5 paraqisni juve.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por disa
7 janë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, dakord.

9 Ne jemi të shqetësuar me Pikën 3. Është çështja e
10 ndalimit të paligjshëm dhe e arrestimit të paligjshëm dhe të
11 ndalimit. Janë 34 paragrafë të aktakuzës në këtë pikë. Nga
12 paragrafi 61 deri 95. Dhe nuk ka nevojë, sipas Prokurorisë, që
13 të ekzistojnë kushtet e keqtrajtimit fizik apo mendor përveç
14 arrestimit të paligjshëm që të ketë shkelje të ligjit. Pra,
15 janë 34 paragrafë për të cilët bëhet fjalë.

16 Pra, hapi i parë është që Prokuroria do të argumentojë
17 që, në qoftë se ata argumentojnë që ka ekzistuar një ndalim i
18 paligjshëm, pra, arrestim dhe ndalim pa ndjekjen e një ligji
19 të qartë, ata do argumentojnë, mendojmë ne, se edhe në qoftë
20 se ata nuk kanë bërë diçka tjetër atëherë pasoja e mundshme e
21 ndalimit të paligjshëm të parandalimit do të ishte që njerëzit
22 do të arrestoheshin, vriteshin, keqtrajtoheshin e kështu me
23 radhë.

24 Pra, përgjigja ndaj pyetjes suaj është pak më e
25 ndërlikuar në kuptimin që, ne do të mbështetemi në Pikën 3 dhe

1 do ta shpjegoj pas një çasti se përse, por, kjo në fakt, ka të
2 bëjë me të gjitha ato që rrjedhin nga Pika 3, që ka të bëjë me
3 krimet e ndërmarrjes kriminale të përbashkët III.

4 Pse është kjo e veçantë për pikën 3? Ju e dini numrin e
5 çështjeve që janë pjesë e kësaj pike sipas së drejtës
6 ndërkombëtare dhe një nga këto çështje që do të ngremë është
7 dhe çështja e vetëmbrojtjes pasi janë dy pyetje të cilave nuk
8 i ka dhënë përgjigje ZPS-ja.

9 E para, këtu bëhet fjalë për një aktor jo shtetëror në
10 një konflikt jo ndërkombëtar. Pra, një aktor që nuk është
11 shtet është kjo çështje dhe pyetja e parë për të cilën nuk
12 është shprehur Prokuroria është: Nëse UÇK-ja e cila nuk ka
13 pasur autoritet ligjor dhe ishin aktorë autorë jo shtetëror
14 sipas ligjit serb dhe jugosllav të asaj kohe, ato a kanë pasur
15 autoritet për të ndaluar ndokënd? Ai është, pra, synimi i ZPS-
16 së të tregojë që ato nuk ka pasur autoritet sipas ligjit
17 jugosllav apo serb dhe se çdo ndalim nga UÇK-ja përse është
18 bërë në mungesë të ligjit dhe në këtë mënyrë ka qenë arbitrar?
19 Kjo është e para.

20 E dyta: Edhe në qoftë se ata pranojnë që nuk kanë pasur
21 ligj të brendshëm ku të mbaheshin si aktorë jo shtetëror nën
22 një konflikt të armatosur jo ndërkombëtar, a është kjo, a kanë
23 pasur të drejtë sipas ligjit ndërkombëtar? Edhe këtë nuk e
24 kanë treguar.

25 Pra, le ta pranojmë, se kanë pasur kompetenca për të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 43

1 ndaluar si aktorë jo shtetërorë në një konflikt jo
2 ndërkombëtar. Atëherë do të kaloj në pyetjen tjetër dhe do ta
3 trajtojmë këtë në çështjen Mustafa, në aktgjykimin Mustafa:
4 Cilat janë, pra, garancitë procedurale që një aktor jo
5 shtetëror në një konflikt jo ndërkombëtar do t'u japë njerëzve
6 të cilët i mban në parandalim?

7 Dhe faktet janë të tilla që UÇK-ja në kohën e ngjarjeve
8 për të cilat flitet këtu kundërshtonte një shtet. Pra, kur
9 flitet për një proces ligjor garancitë tradicionale të cilat
10 paraqiten sipas nenit 14 të Konventës Ndërkombëtare mbi Të
11 Drejtat Politike dhe Civile, neni 6 i Konventës Evropiane mbi
12 Të Drejtat e Njeriut dhe të cilat janë paraqitur, janë
13 mbrojtur nga një gjykatë ndërkombëtare. Kështu është.

14 Pra, në qoftë se Prokuroria e pranon që e kanë pasur
15 pushtetin për të ndaluar si UÇK por që nuk kanë siguruar
16 garanci procedurale, përfshirë dhe të drejtën për të
17 shfrytëzuar një rend ligjor të njohur, atëherë si do të ishte
18 UÇK-ja në gjendje ta bënte një gjë të tillë si? Duke krijuar
19 Gjykata *ad hoc*? Dhe në qoftë se po, mbi bazën e cilit ligj dhe
20 cilin do ta zbatonin ato? Apo ishte kjo një çështje në të
21 cilën të ndaluarit do të duhej të dërgoheshin përpara
22 gjykatave serbe me qëllim që garancitë të paraqiteshin dhe
23 rishikoheshin nga gjykatësit serb? Pra, cili ligj sipas ZPS-
24 së?

25 A bëhet fjalë këtu për ligjin e Serbisë? Pra, në qoftë se

1 ndalohet, për shembull, një luftëtar serb, a duhet që çështja
2 nëse ky do të ndalohet, një luftëtar serb, do të trajtohet nga
3 një gjykatë serbe apo dikush tjetër. Këto janë çështjet të
4 cilat do të ngrihen.

5 Por në këtë kontekst do t'ju tërheq vëmendjen juve si
6 Trupi Gjykses ndaj diskutimit të vendimit të apelit të
7 Gjykatës së Apelit në rastin e kundërshtimit të juridiksionit
8 të Dhomave të Specializuara në datën 23 dhjetor 2021,
9 paragrafi 95, dhe citoj ku thotë:

10 "Paneli do të trajtojë çështjen e mocionit të Veselit për
11 sa i përket bazës ligjore të ndalimit dhe vendimin e
12 Gjykatësit të Procedurës Paraprake se privimi i lirisë në një
13 konflikt jo ndërkombëtar ishte arbitrarisht sipas të drejtës
14 ndërkombëtare humanitare. Që në fillim, Trupi Gjykses bie
15 dakord me Mbrojtjen që fakti që ka ndodhur një gjë e tillë nën
16 një konflikt jo ndërkombëtar nuk nënkupton domosdoshmërisht që
17 kjo është e ndaluar si sjellje. Dhe në këtë mënyrë, Trupi
18 Gjykses është i mendimit që kjo do të bënte të mundur që
19 privimi i çdo lirie të jetë arbitrarisht sipas të drejtës
20 ndërkombëtare".

21 "Përveç kësaj, siç është pranuar edhe nga Gjykatësi i
22 Procedurës Paraprake, mund të ketë edhe burime të tjera përveç
23 të drejtës ndërkombëtare për këtë bazë".

24 Dhe prandaj argumentet tona, nuk janë ekskluzivë, por
25 janë një nga argumentet që do të ngremë dhe që është e drejta

1 e vetë Mbrojtjes, së pari, a i ka dhënë ligji serb UÇK-së të
2 drejtën për të ndaluar. Dhe po i referohem nenit 9 të Kodit
3 Penal të 1976 së Jugosllavisë, që neni 9, paragrafi 1, ku
4 thotë që:

5 "Një akt i bërë nuk është akt i Mbrojtjes -- një akt i
6 bërë në vetëmbrojtje nuk është domosdoshmërisht akt penal".

7 Pra, për t'ju përgjigjur asaj që tha Prokuroria më herët,
8 unë do të them që, për shembull, tortura ndalohet sipas të
9 drejtës ndërkombëtare dhe prandaj tortura nuk pranohet si akt
10 i vetëmbrojtjes, pra, nuk lejohet. Me këtë jemi dakord.

11 Por, çështja është nëse ndalimi i paligjshëm është krim
12 apo jo dhe kjo është një vetëmbrojtje? Dhe ne mbështetemi në
13 nenin 9 të Kodit Penal të 1976 së Jugosllavisë, ku thuhet që
14 mund të ndalohen. Dhe Paneli i Gjykatës së Apelit e ka thënë
15 që mund të ketë edhe burime të tjera që i kanë lejuar UÇK-së
16 të ndalojë njerëzit dhe kjo është e drejtë e vetëmbrojtjes.

17 E dyta çështje që ngrihet, janë garanci procedurale për
18 një aktor jo shtetëror në një konflikt jo ndërkombëtar, a
19 ndodh që dikush që është duke u sulmuar dhe shfrytëzon
20 vetëmbrojtjen dhe në këtë mënyrë bën ndalimin e një personi a
21 mund ta bëjë këtë? Dhe përpara se të ndërtohen gjykatat *ad hoc*
22 të cilat të mund ta vlerësojnë nëse është i ligjshëm apo jo ky
23 parandalim.

24 Ne do të argumentojmë që vetëmbrojtja është diçka që
25 duhet të shqyrtohet në këtë kontekst dhe kështu mund të jepen

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 46

1 garanci procedurale. Pra, ky është një argument shtetës.

2 Ne do të citojmë edhe dy gjëra tjera. Në çështjen në
3 Kordic dhe Cerkez, Trupi Gjykues tha që:

4 "Argumentet e vetëmbrojtjes duhet të vlerësohen mbi bazën
5 e fakteve dhe rrethanave specifike për secilën prej pikave të
6 aktakuzës".

7 Ky është paragrafi 452 i aktgjykimit Kordic dhe Cerkez.
8 Këto janë çështje të cilat do të duhet të vlerësohen
9 plotësisht. Por janë një numër i madh çështjesh që do të
10 ngrihen dhe do të jenë disa prej çështjeve do të kërkojmë
11 mendimin tuaj si Trup Gjykues.

12 Dhe pika e fundit e cila nuk është e kufizuar thjesht tek
13 çështja e vetëmbrojtjes por ka të bëjë me krimet serbe dhe
14 ofensivën serbe e kështu me radhë dhe kjo ndër lidhet edhe me
15 pyetjen që bëri Gjykatësi Mettraux për sa i përket kontrollit
16 efektiv. Çështja e sjelljes së forcave serbe është e
17 ndër lidhur me çështjen e kontrollit efektiv dhe ne do t'ju
18 kërkonim juve, do t'ju tërhiqim vëmendjen juve ndaj çështjes
19 Oric në çështjen Srebrenica, paragrafi 503 dhe 504:

20 "Duke pasur parasysh rrethanat kaotike gjatë rrethimit të
21 Srebrenicës... Trupi Gjykues nuk mund të arrijë në përfundimin
22 që forcat e armatosura në Srebrenicë kanë pasur kontroll
23 efektiv lidhur me njësitë policore në Srebrenicë..."

24 "Për këtë arsye Trupi Gjykues nuk është i bindur tej
25 dyshimit të arsyeshëm që i akuzuari si komandant i Shtabit të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 47

1 Forcave të Armatosura në Srebrenicë nuk ka pasur kontroll mbi
2 policinë ushtarake në Srebrenicë...”

3 Pra, rrethanat kaotike në Srebrenicë kanë lidhje të
4 drejtpërdrejtë me çështjen e komandës dhe të përgjegjësisë si
5 komandues. Ne do ta argumentojmë se rrethanat kaotike dhe për
6 shkak të ofensivës serbe, kryesisht në verën e vitit 1998, por
7 edhe në mars të vitit 1999, kanë pasur një pasojë të
8 drejtpërdrejtë lidhur me kontrollin efektiv të Shtabit të
9 Përgjithshëm dhe të të akuzuarit në mënyrë të veçantë, si dhe
10 çështja e krimeve serbe në atë kohë, janë të gjitha të
11 ndërlydhura.

12 Ju kërktoj ndjesë që kam marrë kaq shumë kohë, të nderuar
13 Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po të
15 supozojmë, sa për argument, për një çast që UÇK-ja ka pasur
16 mundësinë që t'i ndalonte njerëzit për mbrojtjen e tyre.
17 Atëhere cili është detyrimi që ata kishin për t'u dhënë këtyre
18 personave?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Të drejtat minimale sipas të
20 drejtës ndërkombëtare. Kjo është çështja që po them. Ata nuk
21 mund të -- unë po them që nuk mund t'i torturosh njerëzit, t'i
22 vrasësh njerëzit, janë disa gjëra të cilat janë të ndaluara.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Problemi
24 është, që të gjitha ngjarjet të cilat i shqyrtojmë këtu,
25 fillojnë me një person i cili fillimisht mbahet si i ndaluar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 48

1 Dhe më pas ndodh diçka tjetër dhe unë nuk po i kuptoj dot të
2 gjitha këto fakte, Në qoftë se ndodhin gjëra të këqija dhe
3 UÇK-ja thotë "Jo, duke qenë se na keni akuzuar sipas
4 ndërmarrjes së përbashkët kriminale III apo I, ne nuk do t'i
5 diskutojmë këto çështje. Pasi kemi një argument të
6 vetëmbrojtjes këtu që shfrytëzohet"

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, unë nuk e thashë një gjë të
8 tillë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju e thatë që
10 vetëmbrojtja mund të shfrytëzohet për të tëra rastet për shkak
11 të aktakuzës si pjesë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Atëhere ka një keqkuptim këtu.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere ju
14 kështu e filluat.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po t'i hidhni sytë vetëm torturës
16 si aktakuzë, të themi personi A, B apo C është torturuar dhe
17 kjo është pika e aktakuzës dhe në qoftë se e thoni që tortura
18 është bërë si vetëmbrojtje. Dakord.

19 Por argumenti është që një nga aktakuzat mund të zbatohet
20 dhe për aktakuzat e tjera dhe një -- dhe unë kur po flas për
21 këtë po flas vetëm për pikën e ndalimit të paligjshëm. Kjo nuk
22 do të thotë që Pika 3 do të justifikojë të gjitha veprimet e
23 të gjithë të tjerëve në bazë të mbrojtjes si argument
24 vetëmbrojtjeje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por kështu e

1 kam kuptuar këtë argument.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, jo, ka të bëjë thjesht me
3 përgjegjësinë në masën në qoftë se një person ishte përgjegjës
4 për një ndalim të paligjshëm, pikë. Dhe unë do të sqaroj më
5 tej kur them që njerëzit janë ndaluar në mënyrë të paligjshme
6 dhe ju kanë ndodhur disa gjëra atyre. Nuk po them që kjo bëhet
7 fjalë në të tërë 34 paragrafët e aktakuzës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, tani ju
9 po më keqkuptoni mua. Unë po them që çdo person i këtij grupi
10 të cilit, le të themi, i ka ndodhur diçka e keqe - si torturë,
11 vrasje e kështu me radhë - të gjithë këta persona fillimisht
12 janë arrestuar. Janë arrestuar.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe atëherë
15 nuk po kuptoj se cili është qëndrimi juaj atëherë. Në rastin
16 që ne nuk e kundërshtojmë çështjen e arrestimit apo të
17 ndalimit. Atëhere gjërat e tjera nuk varen nga ky ndalim i
18 paligjshëm.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po themi të njëjtën gjë. Ne nuk po
20 e zbatojmë argumentin e vetëmbrojtjes për një kryes i cili ka
21 vrarë dikë. Pra, ne nuk po themi që vrasja justifikohet nga
22 argumenti i vetëmbrojtjes. Ne po themi që për sa kohë që
23 klienti ynë është përgjegjës për veprimet e tij sipas
24 ndërmarrjes së përbashkët kriminale III, në qoftë se thuhet që
25 ai është përgjegjës dhe, për shembull, ka një pretendim që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 50

1 gjendet në paragrafin -- prisni sa ta gjej. Në paragrafin 12
2 të dosjes së ZPS-së. Ja një nga pretendimet e ngritura:

3 "I akuzuari ka marrë pjesë në synimin e mëparshëm
4 kriminal përmes njohurisë që ka pasur lidhur me rrethanat në
5 të cilën janë zbatuar disa politika nga disa prej
6 kundërshtarëve përfshirë edhe abuzimin si rezultat i
7 mosdhënies së garancive të duhura".

8 Pra, *mens rea* është që nuk pasur një rishikim të ndalimit
9 të tyre nga gjykata të ndryshme dhe kanë pasur njohuri që kanë
10 ekzistuar këto rrethana në të cilat kanë ndodhur këto gjëra,
11 pra, janë pjesë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale I. Dhe
12 mbajnë përgjegjësi, në qoftë se një person pa njohurinë e
13 tyre, pra, ka vrarë dikë, ka torturuar dikë e kështu me radhë
14 edhe ti mban përgjegjësi për këtë.

15 Pra, çështja jonë është që është argumenti i
16 vetëmbrojtjes mund të shfrytëzohet për autoritetin për të
17 ndaluar apo jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
19 studiojmë këtë çështje, e vlerësojmë ndershmërinë tuaj.

20 Kam edhe nja dy pyetje të tjera. Dhe janë më shumë
21 teknike. A jemi dakord që përmes mbrojtjes ekziston gjithsesi
22 barra për të paraqitur prova të cilat do të kërkojnë që
23 çështja gjithsesi të shqyrtohet dhe pastaj Prokuroria të ketë
24 barrën përsëri për të thënë që kjo është çështje e
25 vetëmbrojtjes.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 51

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është korrekte, e saktë. Jemi
2 dakord që ka një çështje që është e ndërlidhur dhe ka të bëjë
3 me ofensivën serbe dhe me krimet serbe të diskutuara më herët.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kujdes për
5 këtë gjë. Kujdes për këtë.

6 Ne nuk duam që kjo çështje penale të jetë një çështje e
7 procedimit të krimeve serbe.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne jemi avokatë të Mbrojtjes, ne
9 nuk procedojmë asgjë nga pikëpamja penalisht.

10 Por do t'ju thosha që po të shihni gjyqin dhe aktgjykimin
11 në Oric do të shihni çështjen e rrethimit të Srebrenicës dhe
12 të kontrollit të efektshëm. Dhe do të shihni që ekzistojnë
13 situata të krahasueshme dhe prandaj ne po jua paraqesim këtë
14 dhe ne prandaj po themi që krimet serbe dhe ofensiva serbe
15 janë me vlerë për këtë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe tani po
17 t'i kthehem çështjeve thelbësore të vetëmbrojtjes si
18 argument, a jemi dakord që duhet të tregohet që i akuzuari ka
19 vepruar në mënyrë të arsyeshme për të mbrojtur veten në këtë
20 çështje? Pra, ekziston një arsye. Kështu e kuptojmë?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, ashtu. Unë nuk mendoj që
22 vetëmbrojtja mund të jetë e paarsyeshme si vetëveprim i
23 paarsyeshëm.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe duhet që
25 kërcënimi të jetë i menjëhershëm dhe i paligjshëm.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të jetë
3 proporcional me rrezikun e paraqitur.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ju këtu
6 po paraqisni argumentin e vetëmbrojtjes përmes një tjetri?
7 Bëhet fjalë për faktin që dikush tjetër i ka kryer aktet dhe
8 kjo është vetëmbrojtëse dhe kjo është çështja që ju doni të
9 zbatoni për klientin tuaj?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk jam i sigurt që të jetë
11 ekzaktësisht kështu. Por, po dhe përsëri po e ilustruj me
12 çështjen e ndalimeve. A ishin të arsyeshme ndalimet apo
13 njohuria që janë ndaluar disa persona? A ishte kjo e
14 arsyeshme? A ishte proporcionale? A ka ardhur si përgjigje
15 ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë?

16 Në qoftë se z. Thaçi, po i marrim një nga një, pra, në
17 qoftë se z. Thaçi ka pasur njohuri që komandantët kanë ndaluar
18 persona të cilët ishin kriminelë lufte dhe për këtë do të
19 japim prova të mëtejshme, thjesht po jua paraqes si ide tani.
20 Ka ndaluar dikë nga pala serbe që është kriminel lufte, pra,
21 luftëtar i palës tjetër, a është e arsyeshme, proporcionale
22 për ta bërë një gjë të tillë? Ne do të thoshim po.

23 Pra në këtë kontekst, ne nuk po themi që veprimet e një
24 personi që e ka bërë këtë ndalim mbulohen nga vetëmbrojtja por
25 sipas nenit 9, të ligjit serb, mund ta ndaloni një person. Dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 53

1 ne do të argumentonim që në këto rrethana kjo lejohet edhe nga
2 e drejta ndërkombëtare.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësoj.
4 Ma latë fjalinë në gjysëm në fakt.

5 "Trupi Gjykes thekson se operacionet ushtarake për
6 vetëmbrojtje nuk janë justifikim për shkelje të të drejtave
7 ndërkombëtare humanitare".

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e lashë për gjysëm. Po e
9 trajtoja. Në qoftë se është një shkelje e rëndë --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani kjo
11 është pikëpyetje. A është një shkelje e rëndë e të të drejtës
12 ndërkombëtare? Ju më thatë sa e vështirë e komplikuar është
13 kjo përgjigje.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani pika ime është ndalimi, a
15 është vërtetë shkelje e rëndë e të drejtës ndërkombëtare
16 humanitare apo jo?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'u jap
18 mundësi dhe ekipeve të tjera të Mbrojtjes të parashtrojnë
19 diçka.

20 Z. Emerson, a keni diçka?

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk ka dyshim se ekzistenca e
22 UÇK-së gjatë vitit 1998 dhe 1999 si një grumbullim njerëzish
23 që thjesht luftonin në kuptimin e gjerë të vet kishte për
24 qëllim të mbronin vendin dhe vendasit, bashkatdhetarët e tyre
25 kundër Serbisë dhe luftimeve. Kjo është padyshim.

1 Ne pajtohemi me ato që tha z. Misetic sa i takon
2 ndalimit. Po do ta them diçka më thjesht, ne do ta
3 argumentojmë se nuk është shkelje e të drejtës humanitare
4 ndërkombëtare apo krim që gjykohet në këtë juridiksion për një
5 grup jo shtetëror të armatosur që të ndalojnë dikë, për
6 shembull, që ka qenë luftëtar armik, që ka qenë civil që
7 merrte në mënyrë të drejtpërdrejtë në luftime - edhe kjo që do
8 të them tani është dhe më e vështirë - që ose është një DPH
9 civil apo një person bashkëpunëtor që dyshohet që i jep
10 informacion armikut.

11 Këto faktorë, ne themi, që nuk janë krime që njihen nga e
12 drejta ndërkombëtare. Dhe, në fakt, rezultati përfundimtar
13 është i njëjti sepse nuk jemi pajtuar specifikisht me
14 argumentin e vetëmbrojtjes për shkak të disa ndërlikimeve që
15 ka kjo; sepse, askush nuk sugjeron se krimet që gjykohen në
16 këtë juridiksion nga kjo Gjykatë mund të trajtohen apo mund të
17 justifikohen me argumentin e vetëmbrojtjes qoftë
18 individualisht ose, siç argumenton Prokuroria, mbi baza
19 kolektive.

20 Ne do ta themi më thjesht. Sigurisht që UÇK-ja ishte një
21 organizatë që synonte vetëmbrojtje. Po qëllimi i NKP-së si pas
22 Prokurorisë ishte që të fitonte kontroll mbi territorin
23 kosovar kundër sulmit serb - dhe në fakt formulimi i
24 përshkrimit NKP këtë sugjeron - që jo domosdoshmërisht është
25 synim kriminal. Dhe Prokuroria nuk mund të thotë që ishte

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 55

1 synim kriminal. Po ata thonë që kjo ndodhi përmes veprimeve të
2 paligjshme. Pra, mjetet e paligjshme janë pikëpyetja këtu.

3 Edhe unë ruaj të njëjtin qëndrim, një grup i armatosur jo
4 shtetëror synonte të ofronte mbrojtje edhe nuk mund të
5 konsiderohet krim që ata të ndalonin apo të arrestonin qoftë
6 luftëtarët armiq apo civilët që merrnin drejtpërdrejt në
7 luftime apo dhe agjentët e zbulimit, nëse dëshironi, që mund
8 t'i themi ndryshe bashkëpunëtor me autoritet serbe.

9 Po arsyeja pse s'e kemi ngritur ne vetëmbrojtjen është se
10 çështja e klientit tim është shumë e qartë, se s'kishte asgjë
11 të tillë, as kontroll, as orientim me orientimin nga lart-
12 poshtë. Nëse persona të caktuar e kanë bërë, atëherë ne mund
13 të themi që nuk mund që të kategorizohet si krim. Pra, në
14 qoftë se ka ndodhur, ne nuk mund të themi se duhet konsideruar
15 si krim.

16 Por, si e kuptojmë ne përpjekjen e Prokurorisë është,
17 okej, po ndodhnin gjëra të ndryshme në vende të ndryshme. Po
18 nuk ishte përfshirë drejtpërdrejt nuk e lidhim dot me të, por
19 kanë ndodhur kaq shumë gjëra sa që s'ka mundësi që të mos ketë
20 qenë i lidhur.

21 Ne themi që s'ka qenë asnjëherë pjesë z. Veseli. Nuk ka
22 pasur asnjë funksion të tillë. Dhe ne do t'ua vërtetojmë ju
23 këtë. Por duhet të kalojmë në procesin për të vendosur nëse
24 një konglomeratë veprimesh përgjatë kësaj periudhe dy vjeçare
25 në Kosovë përbënin apo jo vepra penale sepse kjo është thjesht

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 56

1 një përpjekje e dëshpëruar e Prokurorisë për të vërtetuar
2 ekzistencën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
4 z. Emerson.

5 Z. Roberts, a keni diçka për të shtuar?

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ne pajtohemi si me qëndrimin e z.
7 Misetic dhe të z. Emerson. Mu bë qejfi kur e dëgjova z.
8 Misetic. U ndjeva më i informuar në fakt.

9 Por ne jemi të qëndrimit që dua ta vërtetojë Prokuroria
10 ligjshmërinë e veprimeve. Sa i takon barrës që kemi ne edhe ne
11 nga ana jonë mendojmë që është një aspekt i vështirë. Kur
12 dëgjova z. Misetic dhe ju, e kuptova sesa e vështirë është kjo
13 dhe sigurisht që kërkon një argument të hollësishëm kjo.

14 Po diçka që mund të lind është ndikimi i njoftimit të z.
15 Thaçi për kundrejt të akuzuarve të tjerë. Në fakt, unë s'e di
16 përgjigjen e kësaj, kështu që nuk dua ta parashtroj tani, por
17 nëse vërtetohen elementet sa i takon z. Thaçi dhe ato
18 qëndrojnë dhe për ne dhe ne do të shfrytëzojmë të njëjtën
19 mundësi. Unë s'jam ende i sigurt për përgjigjen, por unë
20 mendoj që kështu është. Edhe do ta ngremë më pas në vijimësi
21 të këtij parashtrimi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
23 z. Roberts.

24 Z. Ellis.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkurtimisht, thjesht dua të them

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 57

1 pikë së pari, se ndonëse z. Emmerson dhe z. Misetic paraqitën
2 në një mënyrë të ndryshme bazën ligjore, ne menduam që i
3 njëjti material faktik vlen dhe për analizën tonë, kështu që
4 ne kundërshtojmë çdo kufizim të prezantimit të fakteve që
5 mbështesin qëndrimin tonë.

6 Së dyti, pajtohem me z. Roberts që një dallim mes dy
7 qëndrimeve mund të jetë pikërisht kush e ka barrën e provës.
8 Ne pajtohemi me z. Emmerson, ne mendojmë që barrën e provës e
9 ka Prokuroria lidhur me këtë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
11 z. Ellis.

12 Para se t'u japim fjalën z. Halling, Gjykatësi Mettraux
13 kishte një pyetje më duket për Mbrojtjen dhe pastaj fjalën e
14 keni ju.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndryshe nga z. Roberts,
16 unë ndihem më pak inteligjent tani që ju dëgjova z. Misetic,
17 kështu që kam nevojë për një sqarim sa i takon mënyrën sesi
18 formuluat ju argumentin e vetëmbrojtjes.

19 Thjesht për ta përmbledhur, a e kam kuptuar unë siç
20 duhet, Prokuroria pretendon veprime të paligjshme, pra, ndalim
21 të paligjshëm dhe arbitrar, përfshirë dhe për arsye të faktit,
22 se nuk kishte procese të ligjshme aso kohe. Tani unë e kuptoj
23 që një element ishte demonstrimi i *actus reus* të këtij veprimi
24 dhe Prokuroria duhet të vërtetojë se, në fakt, nuk ekzistonte
25 bazë ligjore për këtë dhe nëse do t'ia dalin mbanë ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 58

1 vërtetojnë këtë, unë e kuptoj që ju pikërisht këtu do të
2 vlenë argumenti juaj i vetëmbrojtjes, ku do të tregoni që
3 diçka që është konsideruar e paligjshme, në fakt, është e
4 përlligjur për shkak të vetëmbrojtjes.

5 Më duhet të pranoj, unë nuk jam shumë i qartë për
6 parashkrimin tuaj, ju duket sikur sugjeroni që argumenti vetë
7 është, pra, apo thoni ju që vetë argumenti mbrojtës apo
8 mbrojtja parashikon bazën për ndalimin në rastin e parë?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, jo. Më vjen keq, ne pajtohemi
10 me ju dhe propozimin tuaj dhe duhet të vërtetojnë
11 mosekzistencën e ligjshmërisë asokohe. Por nga ana procedurale
12 këtu ne kishim një afat nëse do ta ngremë argumentin e
13 vetëmbrojtjes, duhet ta bënim këtë në shkurt dhe ne e bëmë.
14 Apo absolutisht mos i merrni gjërat që thashë unë këtu si
15 ekskluzive sa u takon pikave të tjera që lindin në këtë
16 kontekst si nga pikëpamja e Prokurorisë po dhe nga ana jonë se
17 do kemi argumente të tjerë për të thënë pse diçka ka qenë e
18 ligjshme.

19 Po thjesht nga pikëpamja procedurale për të bërë
20 njoftimin për Prokurorinë e bëmë këtë njoftim edhe dolën pak
21 gjërat jashtë kontrollit, u bë një parashkrim ku u paraqitën
22 kundërshtime mbi njoftimin tonë dhe kemi pasur shumë
23 komunikime lidhur me këto. Por parashkrimin e bëmë me nxitim
24 vetëm nga pikëpamja procedurale.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po ju fajësoj z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 59

1 Misetic. E vlerësojmë shumë që njoftuat të gjithë. Por unë nuk
2 e kam të qartë, nëse e kam kuptuar unë siç duhet, vetë
3 Mbrojtja si argument të mbrojtës, në fakt, nëse e kam kuptuar
4 unë siç duhet, si një bazë ligjore që për ligj ndalimin. A
5 duhet ta kuptojmë kështu qasjen tuaj?

6 E thënë ndryshe, kushdo që pretendon vetëmbrojtje mund të
7 ngrejë argumentin mbrojtës të vetëmbrojtjes sa i takon
8 ndalimit që është kryer? A deshët të thoshit këtë?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt, po hezitoj se më duket se
10 s'jemi kuptuar.

11 Nëse e shohim nga ligji vendas i zbatueshëm asokohe, kur
12 mundej dikush i UÇK-së me të drejtën serbe mund të ndalonte
13 ligjërisht një oficer policie serbe apo anëtar ushtar?

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë e kuptoj unë, z.
15 Misetic. E kuptoj unë që është barra e Prokurorisë këtu. Unë
16 s'e kuptoj si funksionon, si ju ndihmon ju në këtë kontekst
17 argumenti i vetëmbrojtjes.

18 Apo na thoni që shërben si bazë ligjore në rast se nuk do
19 të kishte dispozita të tjera? Sesi e kuptoj unë argumentin
20 mbrojtës është që qëndron vetëm kur është vërtetuar një veprë
21 penale.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë mendoj se jo. Prandaj
23 unë doja një diapozitiv për t'ju treguar, ta lexonit vetë ju
24 Kodin Penal të Jugosllavisë. Kodi Penal i Jugosllavisë thotë
25 që nëse dikush vepron në vetëmbrojtje, nuk është veprë penale.

1 Nëse lexojmë nenin 9 të kodit të 1997 të ish-Jugosllavisë
2 thuhet, nënparagrafi 1:

3 "Një veprim që kryet për vetëmbrojtje nuk konsiderohet
4 vepër penale".

5 Kështu që nuk pajtohem me ju, që vlen vetëm në qoftë se
6 është vërtetuar kryerja e veprës penale. Nuk është nevoja që
7 të ketë vetëmbrojtje për të vërtetuar veprën penale.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptova qëndrimin tuaj
9 tani.

10 Shkurtimisht, fakti që mbështeteni tek çështja Oric. E
11 pashë pak shkurtimisht. Konstatimet e Trupit Gjykues aso kohe
12 duket sikur tregojnë se Prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë
13 kontrollin efikas nga z. Oric sa i takon policisë ushtarake
14 lidhur me dy elementë. Një është ajo që është rrethanat
15 kaotike në fillim të konfliktit në Srebrenicë. Dhe e dyta
16 është sjellja e Halilovic që ishte shefi i policisë ushtarake.
17 Nuk pashë ndonjë gjurmë të krimeve serbe sa i takon këtyre dy
18 elementeve që mori parasysh Trupi Gjykues asokohe për të dalë
19 për të dalë me këtë konstatim. A ka ndonjë paragraf tjetër?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk mendoj se thashë krimet serbe
21 sa i takon Oric, por thashë rrethimi i Srebrenicës. Nuk besoj
22 se kam ndonjë paragraf apostafat përpara meje ku të diskutojë,
23 të shtjellojë gjykimin e Oric.

24 Por ju thashë që ofensiva serbe, veçanërisht në verën
25 1998-s, e marsin e 1999-s, janë relevante, siç ishin relevante

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 61

1 në çështjen Oric. Dhe ne besojmë se krimet qëndrojnë si për të
2 vërtetuar elementin e vetëmbrojtjes edhe dëmin që u shkaktua
3 dhe sa i takon kontrollit efikas.

4 Sepse ne besojmë që kriminaliteti, përjashtimi i
5 popullatës shqiptare si në verën e 1998 edhe më shumë në
6 marsin 1999 patën ndikim të drejtpërdrejtë mbi kontrollin
7 efikas që mund të kishte pasur Shtabi i Përgjithshëm.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 z. Misetic.

11 Z. Halling, fjala është për ju.

12 Ndjesë. Ju kërkoj ndjesë. Kemi dhe një pyetje tjetër.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam disa pyetje për z.
14 Misetic, kjo ka lidhje me parashtrimin tuaj sa i takon detyrës
15 së UÇK-së si aktor jo shtetëror për t'u ofruar një proces të
16 ligjshëm. Sidomos sa i takon parashtrimin aktorit jo shtetëror
17 për të ngritën gjykata.

18 A po thoni ju që UÇK-ja ishte apo nuk ishte nën të
19 drejtën ndërkombëtare e detyruar të krijonte gjykata?

20 Dhe pyetja e dytë është: A ka ndonjë rast mospërbushje
21 nga ana e UÇK-së për të pasur procese të rregullta ligjore të
22 përjashtuara për shkak të ligjit, se nuk e kishin kompetencën
23 ta bënin këtë sipas të drejtës ndërkombëtare apo serbe, apo
24 justifikohet kjo për shkak të paaftësisë materiale për ta bërë
25 këtë për shkak të shkallës së konfliktit apo - më falni -

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 62

1 kaosit që kishte sjellë konflikti?

2 Pra, e pranoni ju që UÇK-ja si aktor jo shtetëror kishte
3 detyrim sipas të drejtës ndërkombëtare të ngrinte gjykata?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk mendoj se e kishin për
5 detyrim të ngrinin gjykata sepse nuk kishin autoritet, mandat
6 për ta bërë këtë sipas ligjit.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po sipas të drejtës serbe
8 dhe të drejtës ndërkombëtare?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Të jem i singertë, më duhet ta
10 shoh më në hollësi të drejtën ndërkombëtare detyrën për të
11 ngritur gjykatën. Por me të drejtën vendase nuk kishin
12 mandatin të ngrinin gjykata, as me të drejtën serbe.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja e dytë, mosofrimi i
14 procesit të rregull ligjor, ju përmendët disa herë rrethanat e
15 Srebrenicës në fakt kur përmendët dhe Oric. A po thoni ju se
16 mosofrimi i proceseve të rregullta ligjore nga ana e UÇK-së
17 për të ngritur gjykata apo për të ofruar procese të rregullta
18 ligjore për ligjet për shkak të paaftësisë materiale për ta
19 bërë këtë që erdhi për shkak të luftës, pra, për shkak të
20 luftimeve ushtarake dhe të kaosit që mbizotëronte asokohe në
21 Kosovë?

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Para se ti përgjigjet z. Misetiç.

23 I gjithë problemi i aktorëve jo shtetëror këtu për të
24 ngritur apo për të pasur procese të rregullta ligjore dhe
25 ligje është një diskutim ku në fakt duhet shtjelluar më në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 63

1 hollësi. Para se të diskutojmë këto aspekte që janë të
2 vështira për t'u diskutuar në këtë fazë mbase do ishte mirë që
3 t'i shqyrtonim më në hollësi.

4 Se personat që po na ndjekin po kuptojnë sikur Misetic
5 duhet të japi këtu qëndrimin e Mbrojtjes. Është çështje
6 delikate kjo dhe mendojmë që duhet ta parashtrojmë më në
7 hollësi.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, nëse dëshironi
9 mund t'i përgjigjeni.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Pajtohem me z. Emmerson, çështja
11 tani do të trajtohej më mirë me shkrim, sepse ju thatë a
12 s'kanë pasë mundësi që t'i kryejnë, do t'i marrim rast pas
13 rasti dhe të kuptojmë konkretisht se për çfarë aspektesh të
14 procesit të rregullt ligjor po flasim.

15 Unë po përpiqesha të thosha që e ka Prokuroria detyrë dhe
16 jo ne, të na tregojnë provat e veta, çështjen e tyre. I kemi
17 marrë punët nga bishti në fakt, ne po themi që ju nuk i keni
18 detyruar, jo ju konkretisht, nuk janë detyruar asnjëherë të
19 vetme të na e bëjnë të qartë qëndrimin e tyre për këtë, të na
20 e shtjellojnë qëndrimin e tyre. UÇK-ja a kishte kompetenca të
21 ndalonte në çdo rrethanë, po apo jo? Nëse po, mbi ç'bazë
22 ligjore mund ta bënin këtë gjë? Çfarë procesesh të rregullta
23 ligjore pretendon Prokuroria se duhet të kishte ofruar UÇK-ja?

24 Kur ta bëjnë të ditur ata qëndrimin e tyre atëherë do t'i
25 kundërpërgjigjet Mbrojtja provave të tyre. Por ne po përpiqemi

1 këtu të shpjegojmë pse e bëmë njoftimin për të përdorur
2 argumentin e vetëmbrojtjes. Pajtohem me z. Emmerson është
3 çështje e ndërlikuar kjo. Duhet shtjelluar më në hollësi
4 përkufizimi i gjykatave, i aktorëve jo shtetëror edhe z.
5 Emmerson më korrigjo nëse kemi gabim. Por nuk kemi ndonjë
6 precedent ligjor për këtë aspekt. Kam studime, ka analiza. Por
7 nëse një aktor jo shtetëror apo konflikt i armatosur jo
8 ndërkombëtar ka për detyrë të ngrejë gjykata ad hoc është një
9 çështje që duhet ta trajtojmë.

10 Sa i takon procesit të rregullt ligjor, pikëpyetja është:
11 UÇK-ja apo i kërkohej UÇK-së të ngrinte gjykata për qëllim të
12 nenit 141 dhe nenit 16(4), a mund ta bënin dhe nëse nuk e
13 bënin dhe nëse nuk e kryen, atëherë a vepruan në shkelje të
14 bazës ligjore të ligjeve?

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. HALLING: [Përkthim] E di që po i afrohem orës 11.00,
17 po unë do flas shkurtimisht.

18 Kjo është një çështje shumë e ndërlikuar. Kjo nuk është
19 vetëmbrojtje. Nuk po flasim për vetëmbrojtje këtu. Nëse
20 ndalimi nuk është arbitrar, atëherë nuk është përmbushur
21 elementi i ofensivës. Por kjo nuk përjashton përgjegjësinë
22 penale. Dhe nëse ndalimi ishte apo jo arbitrar është tërësisht
23 i pavarur nga çdo pretendim lidhur me krimet serbe, sepse, në
24 fakt, për këtë bëhet fjalë.

25 Nuk ka rëndësi sa kaotike ishte lufte, nuk mund të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 65

1 torturosh njerëzit as mund t'i vrasësh, për këtë pajtohemi, as
2 nuk mund t'i ndalosh në mënyrë arbitrare.

3 Trupi Gjykses i ka përcaktuar qartë kufijtë mbi provat
4 kryesore për krimet e pretenduara serbe në këtë gjykim.
5 Mbrojtja nuk mund të ngrejë arsye të dyshimta për të
6 përjashtuar përgjegjësinë penale thjesht për t'u shmangur
7 këtyre përgjegjësi. Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë bëjmë
9 gjysëm ore pushim. Ose 45 minuta mbase. Ju kërkoj ndjesë z.
10 Emmerson kishit diçka për të thënë.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Para se të bëjmë pushimin, se
12 mbase gjatë pushimit mund të reflektojmë pak lidhur me këtë
13 pikë. Nuk po flas për argumentin e vetëmbrojtjes këtu po për
14 ndalimin arbitrar që lindi tani këtu ose që u përmend tani
15 këtu.

16 Pajtohemi se me një formulim të thjeshtë nga ZPS-ja, se e
17 kanë për detyrim ta vërtetojnë se ka pasur ndalim arbitrar.
18 Por "arbitrariteti" është një nga fjalët më të vështira,
19 sidomos lidhur me ndalimin në të drejtën ndërkombëtare.

20 Për shembull, ndonëse vlente atëherë apo zbatohej e
21 drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut aso kohe në
22 konfliktin e armatosur, ne e dimë, që herë pas here sistemet u
23 mbivendosën me njëri-tjetrin dhe sigurisht synimi ishte
24 shmangja e konfliktit. Kështu që kur vendosim nëse vdekja
25 është vrasje e paligjshme arbitrare, sipas nenit 2 të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 66

1 Konventës Evropiane të ë Drejtave të Njeriut referenca i bëhet
2 të drejtës humanitare. Çdo vrasje gjatë një lufte apo një
3 konflikti që është një shkelje me të drejtën ndërkombëtare
4 humanitare është arbitrare, sigurisht ne jemi në atë situatë
5 sa i takon ndalimit tani nga një grup i armatosur jo
6 shtetëror.

7 Është e padrejtë që Prokuroria ose në mënyrë të pasaktë
8 Prokuroria thotë që ndalimi arbitrar është si tortura apo
9 vrasja e një personi që është mbajtur i ndaluar dhe është e
10 paligjshme. Por tani si e përkufizoni ju arbitraritetin? Këtu
11 është pikëpyetja. Dhe kjo duhet të ishte sqaruar ose të paktën
12 të dinim qëndrimin e Prokurorisë. "Arbitrariteti" mund të ketë
13 shumë kuptime. Nëse nuk ka një përkufizim të qartë duhet ti
14 përgjigjeni pyetjes me anë të referencave duke e pasur
15 parasysh të drejtën ndërkombëtare humanitare.

16 Unë sugjeroj që Trupi Gjykues të urdhërojë të
17 përkufizojnë çfarë nënkuptojnë ata me kufijtë e aftësisë së
18 aktorëve jo shtetëror për të ndaluar përpara se ky të kthehet
19 në veprim arbitrar.

20 Sigurisht, mund të flasim për procesin e rregullt ligjor
21 por kjo është pas ngjarjes. Kjo është një çështje më vete.
22 Sepse nëse ka arsye të dyshimta, nëse nuk përmbushin kriteret
23 për arsyen e dyshimit për ndalimin mbase s'do kishim fare
24 gjykim. Sepse s'kishte gjykata që të operonin asokohe.

25 Pra, ne do t'i ndihmojmë të gjithë edhe ZPS-në edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 67

1 sidomos Trupin Gjykses e sidomos Mbrojtjen, ta fillonim këtë
2 gjykim duke pasur të qarta përkufizimet, kështu që Prokuroria
3 duhet të na thotë qartë çfarë nënkupton me "arbitraritet".

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për kohën.

5 Pajtohem me z. Emmerson, fatkeqësisht për procesverbal,
6 ne nuk po fabrikojmë asgjë. Çdo argument e kemi të bazuar në
7 arsye të vlefshme se ne mendojmë që ka problematika ligjore që
8 duhen trajtuar.

9 Folëm gjithë paraditen sot për racionalizimin,
10 thjeshtimin e çështjes, të kursejmë kohën, të hyjmë në thelb
11 të çështjes. Do të ndihmonte ne të dinim për çfarë po
12 argumentojmë, çfarë është arbitrare, çfarë mendon ZPS-ja se
13 është arbitrare, se mbase pastaj në qoftë se do sqarohet kjo,
14 mbase do shmangnim një pjesë të provave nëse ata, për
15 shembull, thonë që UÇK-ja kishte mandatin të ndalonte. Çfarë
16 përbën proces të rregullt ligjor në qoftë se ke të drejtën të
17 ndalosh një person? Ku konkretisht nuk u realizua procesi i
18 rregullt ligjor? A kishte nevojë për gjykata?

19 Mbase këto do i diskutojmë mes palëve. Në fakt, me
20 kënaqësi do ta kishim bërë këtë. Po sa më shumë ta ngushtojmë
21 fokusin e këtyre çështjeve aq më shumë kohë do të kursenim në
22 këtë Gjykatë. Faleminderit.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dua të shtoj që diskutimi që kemi
24 bërë sot paradite, nuk ka rëndësi sa inteligjent ndihemi
25 lidhur me këtë diskutim, po vështirësia e këtij debati

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 68

1 ilustron pikërisht çështjen që ngrita unë. Ekipi i Veselit ka
2 arritur në të njëjtin rezultat ndonëse përmes rrugëve të
3 tjera, që do të thotë produkti është që askush në këtë sallë
4 gjykate nuk e di kush është objektivi, çfarë është
5 arbitrariteti, çfarë nënkupton arbitrariteti.

6 Prandaj, duhet të këtë një shtjellim me shkrim sidomos
7 për të plotësuar dosjen paraprake, sidomos për pikat që
8 pajtohen dhe nuk pajtohen palët dhe kjo duhet kryer, duhet të
9 fillojë me Prokurorinë. Se shumica e akuzave në aktakuzë
10 lidhen me ndalimet ose kalojnë përmes ndalimit. Do rrimë këtu
11 gjashtë a dhjetë vjetë të vendosim e do dëgjojmë prova lidhur
12 me ndalimin pa rënë dakord fillimisht a ka qenë i ligjshëm apo
13 jo ndalimi.

14 Prandaj mendoj se duhet ta trajtojmë këtë dhe shumë
15 shpejt.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
17 z. Emerson.

18 A ka ndokush tjetër ndonjë pikë tjetër për të ngritur?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë një
21 pushi. Kthehemi në orën 11.30.

22 --- Pauza fillon në orën 11.01

23 --- Seanca rifillon në orën 11.30

24 [I akuzuari Veseli nuk është i pranishëm]

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të ngre një çështje, të

1 nderuar Gjykatës?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Diçka lidhur me përkthimin e
4 transkriptit të procedurave të sotme. Juve ju kujtohet që e
5 kundërshtova pohimin e Prokurorisë se z. Veseli ka qenë anëtar
6 i Shtabit të Përgjithshëm gjatë gjithë periudhës së aktakuzës
7 dhe vura në dukje se u largua nga Shtabi në pranverë të 1999-
8 s, me marrjen e masave të tjera lidhur me qeverinë e ardhshme
9 të Kosovës.

10 Edhe pse duket se është regjistruar korrekt në
11 transkriptin në anglisht, pra, siç thashë që nuk ka qenë
12 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm pas periudhës së pranverës,
13 duket në përkthim, mbase nuk më dëgjoi përkthyesi, që "u bë
14 anëtar i Shtabit në atë kohë". Pra, e kundërta e asaj që
15 thashë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
17 pasqyrojmë këtë gjë. Gjithashtu dhe faktin që për arsye të
18 mirëqena, z. Veseli është larguar nga Zoom-i dhe ka hequr dorë
19 nga prania, siç duhet të bëjë, kështu që jemi në rregull.

20 Kam një pyetje për ju z. Halling që lidhet me këtë që
21 kemi diskutuar. Nuk është një diskutim i përgjithshëm, por
22 është vetëm ju.

23 Dua të di nëse qëndrimi i ZPS-së është që keni një bazë
24 të ligjshme sipas të drejtës ndërkombëtare që në rrethanat e
25 kësaj mosmarrëveshjeje për të cilën po diskutojmë, të

1 parandalohet dikush, të mbahet i ndaluar.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Përgjigja ime është po. Por sa për
3 ta sqaruar si e kuptoj unë.

4 Nuk jemi me pikëpamjen absolutiste që po diskutonte z.
5 Misetic që asnjë parandalim i UÇK-së mund të ishte i ligjshëm.
6 Neve jemi të mendimit që paraburgimi arbitrarisht për të cilën
7 akuzohet këtu është fakt i paligjshëm.

8 Ne nuk -- ne i përmbahemi arsyeve të vendimit.

9 Neve kemi vënë -- kemi përfshirë të gjitha propozimet
10 tona në propozimin që iu bë Mbrojtjes muajin që shkoi. Por ata
11 nuk e pranuan. Ky është qëndrimi ynë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një
13 herë, bazë e vlefshme ligjore për të mbajtur të ndaluar. Vetëm
14 për këtë, nuk po diskutoj anën arbitrare.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Ka bazë ligjore për të mbajtur të
16 ndaluar dikë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Halling, nuk e di se cila
18 është baza ligjore sipas jush që do të miratonte të drejtën
19 për të mbajtur dikë të ndaluar.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Mbase është më mirë që t'i
21 përgjigjem pyetjes në anën e kundërt. Kështu është në Vendimin
22 e Konfirmimit.

23 Gjendet në paragrafin 54 [sipas përkthimit]:

24 "Heqja e lirisë është pa bazë ligjore kur nuk përlligjet
25 nga shkaqet e arsyeshme apo nga shqetësime të sigurisë të

1 cilat e bëjnë atë të domosdoshme”.

2 Paragrafi tjetër shpjegon më mirë.

3 Siç e shihni, ka vend sipas të drejtës humanitare
4 ndërkombëtare siç e pasqyron, siç pasqyrohet në Vendimin e
5 Konfirmimit, që të ketë një vlerë, të ketë një arsye të
6 ligjshme. Citimi në 94 është me rëndësi për këtë gjë dhe
7 gjithashtu përmendet edhe TPNJ-ja, çështja Kordic. Kështu e
8 kuptojmë ne.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
11 vazhdojmë me pikat e tjera.

12 Të kthehemi te kalendari. Dua të sigurojmë që jemi të
13 gjithë në të njëjtën linjë. Siç e dini synojmë që çështjen ta
14 hapim në 3 prill, në orën 09.00. Palët dhe pjesëmarrësit duhet
15 të respektohet kohën që u jepet për deklaratat hapëse.

16 Nëse do të mbahet ndonjë deklaratë nga të akuzuarit duhet
17 të respektohet koha.

18 Kalendari i deklaratave hapëse është 3 prill deri në 4
19 prill, me shumë gjasa do të jenë deklaratat e ZPS-së, pesë
20 orë.

21 Në 4 prill në orën 09.00 deklaratat hapëse ose nga për
22 pjesën tjetër të dhënë ZPS-së apo Mbrojtjes.

23 Mbrojtja e Thaçit ka maksimumi 3 orë, e Veselit 45 minuta
24 më 5 prill, në orën 09.00. Mbrojtja e Selimit ka maksimumi një
25 orë pasuar nga e mbrojtja e Krasniqit 1.5 orë. Pastaj mund të

1 kemi pyetje nga Trupi Gjykses.

2 U kërkoj të gjithëve të jeni elastikë që të jeni të
3 gatshëm të vazhdoni nëse dikush mbaron më herët të jeni të
4 gatshëm.

5 Gjithashtu, duam që mbrojtësit të përqendrohen
6 ekskluzivisht në çështje që lidhen me akuzat dhe të shmangin
7 çështje të parëndësishme apo deklarata me natyrë politike.

8 Trupi Gjykses shpreson që palët t'i adresojnë çështjet me
9 qartësi, çështje që janë, përbëjnë thelbin e çështjeve tuaja
10 dhe të shmangni sa më shumë përsëritjen e atyre që i dimë nga
11 leximi i dosjeve paraprake. Kërkojmë që të mos ndërprisni
12 fjalën e palës tjetër apo të ndonjë pjesëmarrësi.

13 Ka ndonjë koment nga ndonjë njeri?

14 Po fillojmë me z. Halling.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kam gjë.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam gjë.

17 Z. ROBERTS [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua të
19 theksoj se do të ishte jashtëzakonisht me - do t'i ndihmonte
20 shumë përkthyesit që të dëgjonin si duhesh deklaratat tuaja,
21 që t'u jepni një kopje atyre, të deklaratave përpara,
22 paraprakisht.

23 Kërkojmë nëse ka ndonjë çështje tjetër që doni ta ngrini
24 përpara gjyqit ta bëni tani. Besoj te njerëzit -- Mbrojtja e
25 Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit kanë dhënë, kanë paraqitur disa

1 gjëra.

2 Doni të dëgjoni për këto çështje? Nuk shoh ndonjë mocion
3 formal të paraqitur prej jush.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund ta bëj diçka të tillë pa
5 dyshim. Jam përpjekur të marr pjesë në bisedimet *inter partes*.
6 Mendova se do të ishte më e lehtë për të shkurtuar kohën, pra,
7 për të tërhequr vëmendjen tuaj për ata dëshmitarë që janë
8 transferuar në vende të treta. Lidhur me pagesat, përftimet,
9 ndihmën e ofruar këtyre dëshmitarëve dhe bëhet fjalë për dy
10 dëshmitarë nga 13. Por për ata jurisprudenca është shumë e
11 qartë. Ka të bëjë me kredibilitetin e tyre. Pra, për të gjitha
12 gjërat që kanë të bëjnë me kredibilitetin e tyre.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj dhe
14 po sugjeroj që nëse doni të paraqisni diçka definitive,
15 paraqitni një mocion dhe do t'i përgjigjemi shpejt.

16 Keni gjë tjetër?

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sa i
19 takon Mbrojtjes së Selimit do të them se seanca do jetë kështu
20 si është. E keni ngritur përpara -- njerëzit që do të marrin
21 pjesë në ekipet tuaja do jenë këta që janë. Besoj që e dini se
22 çfarë duhet të bëni lidhur me sigurinë. Në qoftë se doni të
23 bisedoni me klientët do t'jua japim këtë të drejtë. Kështu e
24 kemi bërë edhe përpara. Keni edhe kohë që jemi përpjekur ta
25 rrisim gjatë ditës për të biseduar me klientët gjatë

1 pushimeve.

2 Keni ndonjë gjë tjetër?

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nëse ky është vendimi juaj e
4 vlerësojmë kohën. Do përpiqemi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të jetë
6 diçka e vështirë, nuk duam të ndërhyjmë në komunikimet me
7 klientët.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Shkurtimisht, për
9 çështjen e dytë, afati për t'u përgjigjur parashtimit F1374
10 që është mocioni i dytë lidhur me rregullën 154. Nuk i vë faj
11 Prokurorisë për herë të parë, sepse është vendim mbasi e
12 kishin dorëzuar parashtimin që me siguri do të kërkojë
13 informacion të mëtejshëm lidhur me paragrafët përkatës të
14 dosjes paraprakë me të cilat janë lidhur këta dëshmitarë. Jam
15 i sigurt që Prokuroria është e gatshme ta bëjë këtë dhe ta
16 ridorëzojnë informacion me informacion të përditësuar që të
17 përqendrohemi tek ai në përgjigjet tona dhe duke pasur
18 parasysh angazhimet me fillimin e gjykimit dhe nuk presim që
19 dëshmitarët të vijjnë para disa muajsh kemi kërkuar shtyrjen e
20 kohës për t'u përgjigjur.

21 Pra, kërkojmë që të ridorëzojnë parashtimin apo të na
22 japin informacion të mëtejshëm lidhur me këtë paragraf dhe do
23 kemi 21 ditë dhe jo 10 ditë për t'u përgjigjur për këtë
24 kërkesë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 75

1 keni ndonjë kundërshtim për këtë proces?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë ridorëzimin e
3 mocionit. Nuk ishte ky urdhri juaj. Në qoftë se është kështu,
4 të na thoni se kur doni që ta bëni. Nuk kemi ndonjë afat për
5 këtë gjë. Për sa i takon përgjigjes, kohës për përgjigjen nga
6 10 në 21, kërkojmë, kjo është një kërkesë -- mendojmë që është
7 një kërkesë s arsyeshme.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES: [Përkthim] Duam që të
9 riparaqisni mocionin, atë kërkesën, dhe 21 ditë do të
10 miratohen.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Keni parasysh ndonjë afat?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES: [Përkthim] Cili do të ishte
13 afati i arsyeshëm për ju? Sepse duke qenë parasysh, siç tha z.
14 Roberts, ky nuk është një problem që nuk pret.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Për të qenë konservativë, e
16 premtë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Oh, nuk ju pashë z. Ellis.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Lidhur me mënyrën se si do të rrimë
20 në sallën e gjyqit, kam dy shqetësime konkrete. Një prej tyre
21 është se z. Krasniqi flet shqip. Nuk flet dot në anglisht. Për
22 të komunikuar me të do të kërkonim që të kishim një anëtar të
23 ekipit tonë që flet shqip që të rrinte me ne. Se nuk është
24 kollaj që të kthej kokën sa herë të flas me të. Nuk komunikoj
25 dot në atë mënyrë pa pasur ndihmë, dikë që të më ndihmojë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 76

1 Dhe kjo lidhet në pikën më të përgjithshme, se ka çështje
2 që mund të dalin gjatë seancave për të cilën nevojiten
3 udhëzime dhe mund të na duhet të marrim këto udhëzime në
4 moment dhe jo kur të kemi pushim.

5 Dhe mund të krijojë një farë ndërprerje nëse mbrojtësi
6 kthehet nga klienti dhe sa herë që duhet ta pyesi për diçka.
7 Shpresoj që nuk do të ketë problem me sigurinë që të flasim me
8 klientin ne si avokatë mbrojtës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
10 kufizime për këtë. Do të japim leje sa herë që ju duket e
11 arsyeshme ta bëni këtë. Mjafton që të na tërhiqni vëmendjen se
12 keni nevojë të bisedoni me klientin.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Jam mirënjohës, por normalisht na
14 bie që të kthejmë kokën.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.
16 Por në këtë rast, në këtë konfigurim që kemi, s'kemi ç'të
17 bëjmë. Besoj që keni dikë që flet shqip në ekipin tuaj dhe ky
18 person mund të lëviz bashkë me ju nëse nevojitet.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] A mundet ky personi të rrijë pranë
20 z. Krasniqi?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë do ta
22 diskutojmë sigurinë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Besoj që ju keni pritur që këtë
24 çështje ta shtrojmë të premtë. Po del diçka nga vendimi i të
25 enjtes që pata mundësi ta shqyrtoj gjatë fundjavës dhe jam i

1 detyruar ta ngre në rastin më të parë sipas Rregullores.

2 [REDAKTUAR] i Vendimit [REDAKTUAR] Trupi Gjykues
3 shqetësohet për disa shënime në dokumentin e nënshkruar nga z.
4 Selimi lidhur me [REDAKTUAR], që duket se përmban akuza kundër
5 bashkë të akuzuarit. Nuk kemi ndonjë kundërshtim që të
6 pranohet gjatë procesit. Dhe afatin për të paraqitur
7 parashtrimin e kemi mbasi të ketë dëshmuar ky dëshmitar.

8 Por, ka shumë rëndësi për procesverbal që të them se
9 qëndrimi që përcaktohet në [REDAKTUAR] është që deklarata e
10 z. Selimi se për këtë flet ai shënimi që është nënshkruar nuk
11 duhet vlerësuar sipas rregullës 154, por në bazë të bazë të
12 rregullave, provat materiale 138(1).

13 Çështja është e thjeshtë nëse përmbajtja e kësaj
14 deklarate është paraqitur si provë lidhur me vërtetësinë e
15 përmbajtjes apo lidhur me faktin që janë bërë. Pra provë që
16 lidhet me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit. Në këtë rast
17 bëhet fjalë për deklaratën e z. Selimi.

18 Rregulli 138(1), sepse sipas një 154 nuk trajtohet si
19 deklaratë por si një provë materiale e prodhuar nga
20 dëshmitari. Dhe parimi është rregulli 138(1):

21 "Nëse nuk kundërshtohet apo përjashtohet *proprio motu*,
22 provat e paraqitura Trupit Gjykues duhet të pranohen në qoftë
23 se janë të vërteta dhe kanë vlerë provuese dhe në qoftë se
24 vlera paragjyquese nuk është më e vogël se efekti dëmtues."

25 Pra, ky njoftim ishte autentik, i vërtetë dhe kishte

1 vlerë provuese. Çështja mbetet e hapur nëse efekti dëmtues
2 është më i madh sesa vlera provuese dhe për këtë duhet të
3 dëgjojmë.

4 Në vendimin tuaj ju thoni se pranimi i deklaratës së një
5 të akuzuari nuk duhet të shkelë të drejtat themelore të bashkë
6 të akuzuarve të tjerë. Pra, duke e marrë këtë pa ndonjë
7 kualifikim të mëtejshëm, kërkon që të pyesim për çfarë qëllimi
8 bëhet. Sigurisht është çështje e të drejtës anglo-amerikane që
9 është e mirëprovuar se pranimi i një deklarate jashtë gjykatës
10 që nuk ulet në vendin e dëshmitarëve, që pranohet, duhet të
11 mos jetë kundër të akuzuarve të tjerë. Këtë thotë e drejta
12 anglo-saksone.

13 Megjithatë, kur Gjykata të shqyrtojë efektin dëmtues
14 përkundrejt vlerës provuese [REDAKTUAR].

15 Z. HALLING: [Përkthim] Përpara se të vazhdoj. A mundet që ta
16 bëj këtë, ta ngre këtë çështje në mënyrë abstrakte, pa iu
17 referuar konkretisht dëshmisë?

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Personi që paraqet dëshminë, i
19 pari që do të thirret, akuzon z. Selimi se ka marrë pjesë në
20 zhdukje dhe merr përgjigje nga Selimi se në fakt ka të bëjë me
21 akuza kundër persona të tjerë.

22 Në momentin e duhur, përveçse z. Selimi dëshmon si
23 dëshmitar, ne do të paraqesim në momentin e duhur...

24 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] ...ne themi që nuk mund të

1 përdoret si provë lidhur me të vërtetën dhe veprimet dhe
2 sjelljen e të akuzuarve.

3 E ngre që ju ta keni parasysh dhe pastaj do ta trajtojmë
4 në fund të gjykimit për të parë nëse do të kemi dëshmi të z.
5 Selimi.

6 Rregulli 138(1) vazhdon, në fjalinë e dytë, që do të
7 thotë:

8 "Në rrethana përjashtimore kur Trupi Gjykues është i
9 bindur se çështja nuk ka qenë e njohur në atë kohë kur është
10 paraqitur dëshmia, duhet të ngrihet, të paraqitet menjëherë
11 pasi të bëhet i njohur".

12 Pra, duket se nënkupton që Mbrojtja duhet ta ngrejë këtë
13 çështje sa më shpjet që të jetë e mundur. Dhe në qoftë se
14 ngrihet pasi të jetë paraqitur dëshmia, jo pranuar, por
15 paraqitur, atëherë ora fillon të bjerë për ne që të paraqesim
16 sa më shpejt që të jetë e mundur.

17 Pra, nuk lidhet me pranueshmërinë, por pranueshmëri
18 lidhur me kë dhe për çfarë qëllimi që është një çështje
19 tjetër. Askush nuk po sugjeron që procesverbali nuk mund ta
20 përfshijë këtë gjë. Më e pakta është që është provë në rastin
21 e z. Selimit. Por, do të paraqesim, dhe dua ta them për
22 procesverbal, sapo ta marrim vesh që kjo deklaratë nuk mund të
23 përdoret si provë e besueshme lidhur me të vërtetën për
24 veprimet dhe sjelljen e të bashkë të akuzuarve në qoftë se nuk
25 ka dëshmi të pavarur nga z. Selimi apo ndonjë tjetër për të

1 verifikuar të vërtetën e saj.

2 Më tepër është dëmtues sesa provues, mendojmë ne. Por jo
3 aq sa të mos bëhet po që të mos përdoret për atë qëllim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për një
5 çështje kaq të rëndësishme, sugjeroj që të dorëzoni një
6 parashtrim të shkurtër që ne ta japim vendimin e duhur.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] 16 prilli është afati, por unë
8 do ta bëj përpara sesa të dëshmojë dëshmitari.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
10 shumë.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Për këtë çështje, kjo nuk del
12 [REDAKTUAR], por në rastin e shumë
13 dëshmitarëve.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 MR. HALLING: [Përkthim] Ne mendojmë se ju keni dhënë
17 vendim, duke dhënë vendim për pranueshmërinë e provave
18 materiale të lidhura. Parashtrimet ligjore të z. Emmerson janë
19 shumë interesante, por duhet të ishin ngritur më përpara dhe
20 ne e kundërshtojmë rihapjen e kësaj dosjeje.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja është për ju, z.
22 Emmerson, por z. Halling ma mori nga goja atë që do thoja.
23 Shqetësimi që kam unë ka të bëjë me deklaratën, në qoftë se do
24 ta quanim kështu, që i atribuohet z. Selimi, është ofruar nga
25 Prokuroria si një provë e lidhur dhe duhet të përmbushte

1 kërkesën e rregullës 138(1) dhe ne e kemi trajtuar si të
2 tillë.

3 Pyetja ime është pse nuk i ngritët këto çështje në aso
4 kohe? Sepse po të kishte kundërshtim ndaj pranueshmërisë së
5 tyre në vetvete apo si thoni tani, të pranimit apo dhe/ose
6 përdorimit në lidhje me të bashkë-akuzuarit, a nuk duhej ta
7 kishit ngritur në atë kohë? Në vendimin tonë ka edhe një
8 poshtëshënim ku citohen autoritet që kemi përdorur ku
9 deklarata e një të bashkë-akuzuari, në disa rrethana mundet të
10 përdoret kundër edhe të bashkë-akuzuarve të tjerë.

11 Përse, e kam pyetjen unë, nuk e keni bërë këtë në atë
12 fazë? Sepse unë jam i shqetësuar siç tha edhe z. Halling tani,
13 se ne, ndodhemi në një situatë ku do të kemi kundërshtime ndaj
14 - për vendime për dokumente që janë përfshirë në procesverbal.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] E kemi ngritur shkurtimisht, por
16 afati për paraqitjen e argumenteve lidhur me provat konkrete
17 të pranuar, më thonë që është 17 prill.

18 Së dyti, nuk kundërshtoj paraqitjen e saj për
19 procesverbal, dokumentacionin. Nuk kërkojmë ta përjashtoni.
20 Nuk është shumë vonë që ngremë kundërshtime se si mund të
21 përdoret në mënyrë të ligjshme, legjitime. Është e qartë se
22 është e pranueshme kundër z. Selimi, por është provuar mirë se
23 - në qoftë se nuk provohen akuzat ndaj të bashkë-akuzuarve
24 pesha është shumë e vogël. Po balancosh dëmin me vlerën
25 provuese dhe këtë vlerësim duhet ta bërë ju, që s'e keni bërë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju ndaloj. Pesha është
2 një çështje tjetër. Dhe ne sigurisht nuk do të pengojmë asnjë
3 nga Mbrojtja të bëjë parashtrime për këto çështje që janë
4 legjitime, për të sugjeruar që në mungesë të një konfrontimi,
5 këto deklarata, po i quajmë kështu, duhet t'u jepet pak peshë.

6 Shqetësimi është pse nuk patëm mundësi t'i dëgjojmë këto
7 parashtrime përpara lidhur me, siç e kuptoj unë, këtë që po
8 thoni, fakti që deklaratat e z. Selimi nuk duhen përdorur
9 lidhur me klientin tuaj, që nuk është e njëjta sikur t'i japim
10 peshë, apo jo?

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është e pranueshme -- çështja
12 është qëllimi i përdorimit, jo pranimi i saj.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk dua të filloj ndonjë
14 diskutim të plotë, por precedenti i TPNJ-së, dhe është në
15 rastin e Boskoski, gjithashtu është trajtuar si çështje
16 pranueshmërie pikërisht për atë pikë.

17 Pra, edhe një herë po ju vë ne dukje se nëse do kishit
18 kërkuar ose të bënit parashtrime tyre, unë do të prisja që të
19 shpjegonit se përse këto parashtrime nuk u bënë kur
20 deklaratat, po i citoj, janë ofruar si prova materiale të
21 lidhura. Këtë doja t'ju thoja.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do bëjmë çmos që këtë ta bëjmë
23 në parashtrimin e 16 prill që është afati aktual për të
24 trajtuar këtë çështje. Deri atëherë mbase do ta bëjmë edhe më
25 përpara, përpara se dëshmitari të japë dëshminë duke shpjeguar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 83

1 bazën se përse nuk e kundërshtojmë. Pra, që nuk mund të
2 përdoret kundër të bashkë të akuzuarit sepse për shkak të
3 peshës dëmtuese pa pasur vlerë provuese në rrethanat në të
4 cilat është marrë.

5 Dhe kjo do të eksplorohet edhe në pyetjet që do t'i
6 bëjmë ne si palë e dëshmitarit. Nuk kemi se si ta eksplorojmë,
7 shtjellojmë paraprakisht. Por mendova se koha e përshtatshme
8 për ta ngritur ishte tani.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
10 procesverbal duhet të shënojmë që parashtrimi i ndryshuar që
11 kërkohet nga ZPS-ja, siç kërkon Mbroja e Selimit, duhet të
12 paraqitet me 24 mars dhe përgjigja më 17 prill 2023. Përgjigja
13 e Mbrojtjes për të.

14 Diçka e fundit. Për të qenë shumë të kujdesshëm dua të
15 përsëris faktin që në prill do takohemi më 3, 4, 5 për
16 deklarata hapëse dhe 12, 13 dhe 17 deri në 20, për paraqitje
17 provash dhe në maj 10, 11, 12, 16 deri 23 dhe 22 deri 24, që
18 t'i kemi datat parasysh të gjithë.

19 Ka ndonjë pyetje ndonjë njeri?

20 Emmerson, ju u ngritët në këmbë i pari, flisni.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vetëm një që në kalendarin e
22 publikuar ju korrigjuat atë që shkruhet aty, që data 10 është
23 ditë pushimi nuk është ditë pune. 10 prilli shënohet aty si
24 seance, por në fakt është ditë pushimi.

25 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofoni për Gjykatësin.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Datat e
2 seancës nuk do të përfshijnë datën 10 që është e hëna pas
3 Pashkëve. Dhe po e shpjegoj edhe një herë tjetër që duhet
4 shumë punë për ta mbajtur në funksionim këtë sallë gjyqi dhe
5 do të dëshiroja që të kishim një ditë të katër në shumë prej
6 javëve. Megjithatë, kërkohet shpesh herë që salla e gjyqit të
7 jetë e mbyllur gjatë këtyre ditëve.

8 Faleminderit.

9 A keni ndonjë gjë tjetër z. Misetic?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka shans që Trupi Gjykes të
11 dëshirojë të dëgjojë dëshmi me datën 5 për shkak të kohës së
12 shkurtër që kemi në dispozicion. Kështu është?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, kjo
14 është përgjigja e shkurtër që kam për juve.

15 Z. Kehoe, ju vazhdoni.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë ngrita një çështje që ishte
17 shqetësim i *inter partes* dhe ishte koncepti i imunitetit të
18 kufizuar dhe ç'nënkuptohej me të dhe jam përpjekur ta sqaroj
19 dhe ZPS-ja më ka paraqitur nenin 48 të Statutit. Në karrierën
20 time, të nderuar Gjykatës, kam pasur përvojë të madhe me
21 imunitetin, por nuk kisha ide se çfarë ishte përdorimi i
22 kufizuar i imunitetit. Jam përpjekur ta gjej këtë në statute
23 të ndryshme, në statutet e Kosovës dhe nuk është e qartë fare.

24 Ndaj për sa i përket ZPS-së, dhe lidhur me shfrytëzimin
25 e kufizuar të imunitetit, nuk janë sqaruar ato sa duhet dhe

1 pasojat e saj. Dhe këtu ajo paraqitet si një imunitet, si
2 transaksion që nënkupton që nuk mund të shfrytëzohet ndaj
3 jush, nuk do t'ju procedojmë penalisht. Ky është nënkuptimi.

4 Këtu nuk ka asnjë gjë të qartë të thuhet që z. X ju keni
5 imunitet dhe nuk mund ta shfrytëzoj informacionin ndaj jush
6 por mund të bëj dy gjërat e tjera. Unë mund të gjej dëshmi për
7 t'ju ndjekur juve penalisht, por në qoftë se jeni i dyshuar,
8 ju mbeteni si i tillë, i dyshuar.

9 Për sa i përket konceptit të imunitetit të kufizuar
10 sipas ligjit anglo-sakson është që informacioni që ai jep mund
11 ta shfrytëzoni për të ndërtuar prova kundër këtij personi
12 vetë.

13 Ndërkohë që jurisprudenca e një vendi ose e tribunaleve
14 ndërkombëtare është që - çfarë është kjo. Është më saktësuese
15 se çfarë është kjo. Dhe mua më kanë paraqitur këtu, sa për
16 sqarim, nenin 38(3).

17 Duke qenë se së shpejti do të kemi dëshmitarë të cilëve
18 ju është vënë ajo që quhet imunitet i kufizuar, apo imunitet
19 me përdorim të kufizuar dhe nuk e di se ç'është ndryshimi,
20 koncepti me atë që është, që bëhet si palë e një transaksioni.
21 Pra, ka një ndryshim dramatik imunitetit si transaksion dhe
22 imunitetit të kufizuar. Është një koncept i huaj për mua dhe
23 nuk është e qartë në statute, nuk është e qartë në
24 legjislacionin e Kosovës.

25 E ngre këtë çështje për shkak se është një numër

1 dëshmitarësh të cilëve ju është dhënë ky imunitet me
2 shfrytëzim të kufizuar, pasi unë besoj që ato e kanë si të
3 thuash imunitet si të plotë si transaksion. Dhe këtë po e jap
4 si shënim, sepse ky është thjesht një imunitet i kufizuar.

5 Për sa i përket ZPS-së, nuk na është dhënë asnjë sqarim
6 për pyetjet që kemi ngritur për këtë çështje dhe sigurisht që
7 qartësi nuk paraqitet as në nenin 38 as në nenin
8 legjislationin kosovar. Dhe do t'i kërkoja Trupit Gjykues që
9 të na tregonte - i kërkoj Trupit Gjykues që t'i kërkojë ZPS-së
10 që të na japë sqarimin se cila është baza ligjore e imunitetit
11 me përdorim të kufizuar dhe cila është ndryshimi i tij me
12 imunitetin e plotë si transaksion dhe për ta kuptuar këtë
13 imunitet që i jepet disa prej këtyre dëshmitarëve. Këto janë
14 çështje shumë thelbësore të cilat në fakt do të përcaktojnë se
15 sa i besueshëm është një dëshmitar dhe nëse ata besojnë që
16 ndaj tyre mund të ndërtohet një çështje penale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
18 tjetër a keni për të ngritur?

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk kam.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,
21 doni të përgjigjeni?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Premisa nga ana e avokatit që
23 këtë do ta bëjë si një poshtëshënim në një mocion tregon që
24 kjo duhet të bëhet me mocion me shkrim. Këto dëshmitarë janë -
25 këto kushte janë të paraqitura plotësisht në përputhje me

1 kuadrin ligjor.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse më lejoni të përgjigjem.
3 Ju na keni inkurajuar që të bëjmë diskutime *inter partes* me
4 qëllim që t'i zgjidhim këto me njëri-tjetrin dhe të mos
5 shfrytëzojmë kohën këtu në sallë. Dhe këtë e kemi bërë në një
6 numër korrespondence me avokatët kundërshtarë dhe përgjigja që
7 morëm është që kjo është parashikuar në nenin 38 dhe me kaq
8 mjafton.

9 A ka ndonjë pjesë tjetër të ligjit që unë nuk e di? Nuk
10 e di. Nuk e gjej dot dhe unë kërktoj që ju t'i kërkoni ZPS-së
11 që të na tregojë se ku mund ta gjejmë këtë ligj dhe nëse ka
12 ndonjë ndryshim midis imunitetit me shfrytëzim të kufizuar,
13 imunitetit të shfrytëzuar apo të atij si transaksion. Dhe nuk
14 më kanë sjellë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sa i
16 përket juve, është më mirë që kjo të bëhej me shkrim, në një
17 mocion me shkrim.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, po. Unë mendova
19 me rreziqet e mëdha me të cilat përballohen pyjet e botës, më
20 mirë do të ishte që këto çështje t'i zgjidhim së shpejti.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, dakord
22 jam.

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Një çështje praktike.
24 Dy javët e fundit të majit. Nuk i kam lexuar si duket, shikova
25 transkriptin, plani i punës thotë që do të kemi seancë nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për ecurinë e çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 88

1 data 15 deri me 18 dhe pastaj me datën 22, 23 dhe 24.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga data 15
3 deri më 18.

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] 15 deri më 18 dhe pastaj
5 23, 24, 25?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ashtu
7 është dhe po kështu nga data 10 deri në 12 maj.

8 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Dakord.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur mund të
10 na e jepni përgjigjen tuaj?

11 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kur të dorëzohet mocioni,
12 por prita që kjo të bëhej me shkrim nga ana e palës së
13 Mbrojtjes. Ne mund t'i përgjigjemi sipas afatet statutore apo
14 çfarëdolloj afati tjetër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Problemi
16 është që po vjen një dëshmitar edhe ky është një problem.

17 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Jo, nuk është njëshi. Nuk
18 është dëshmitari i parë në atë rend, në rendin e parashikuar
19 apo në radhën e parashikuar. Kështu që kur të dëshirojë, për
20 ta paraqesë Mbrojtja e Thaçit mocionin do të jemi gati.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur do ta
22 paraqisni këtë z. Kehoe?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Do ta bëjmë shkurt, nuk do të
24 zgjasë shumë kohë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të enjten.

1 Sot është e hënë?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe ju si
4 Prokurori do të përgjigjeni për atë deri të hënë?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po e kuptoj.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më duket se kemi ende paqartësi
7 lidhur me datat e seancave të gjykimit. A thatë ju që ne nuk
8 do të mbajmë seancë me datën 8 dhe 9 por me datën 10, 11 dhe
9 12. Kështu është?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dhe ditët e tjera janë 15 deri
12 18 dhe pastaj 22 deri 25?

13 22 deri më 24. Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse nuk ka
15 ndonjë gjë tjetër për t'u shtuar, seanca mbyllet.

16 --- Seanca mbyllet në orën 12.10

17

18

19

20

21

22

23

24

25